



REVISTË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 48 / Korrik 2023

# DRITA e نور القرآن KUR'ANIT

[www.medreseja.com](http://www.medreseja.com)

MËSIMI I KURANIT NGA PERSPEKTIVA  
E GJYSHIT TIM DHE PERSPEKTIVA IME  
PËR TY HAFIZE E KURANIT  
SELAM PËR TY



Republika e Kosovës  
 Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës  
**SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË**



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
 بِرَبِّكَ الْوَهَّابِ  
 رَبِّكَ الْوَهَّابِ

**"Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona  
 pasi na drejtove, na e dhuro meshiren  
 Tënde! Pa dyshim, vetëm Ti je  
 Dhuruesi i Madh!"  
 (Ali Imran, 8)**

12/4

12/3

**Gjenerata  
 e 22-të  
 Takimi  
 2023**





## PËRMBAJTJA:

- 3 FJALA E KRYEREDAKTORES
- 4 SELAMI I FUNDIT
- 4 TI MEDRESE
- 5 EDHE PO IKA TI MOS MË LE
- 6 TA SHOHËSH PERLËN E QIELLIT
- 6 HANA
- 7 NOSTALGJI
- 7 KAM MALL
- 8 JETA
- 8 MOS!
- 9 KOHA
- 10 PËR TY HAFIZE E KURANIT
- 11 MË MUNGON
- 12 MËSIMI I KURANIT NGA PERSPEKTIVA  
E GJYSHIT TIM DHE PERSPEKTIVA IME
- 14 ATEIZMI, RRUGËT DREJT TIJ, RREZIKU  
DHE SI TË BALLAFAQOHEMI ME TË
- 14 AMBICIA E BESIMTARIT
- 17 AKTIVITETE
- 36 DUAJA E HATMES E GJENERATËS SË  
56-TË TË MATURENTËVE TË MEDRESESË
- 38 GJENERATA E 22-TË E MATURENTEVE  
TË MEDRESESË E BËNË DUANË E  
HATMES
- 40 MBRËMJA E MATURES SË GJENERATËS  
SË 56-TË TË DJEMVE
- 41 PROGRAMI I MBRËMJES SË  
MATURENTEVE TË GJENERATËS SË 22-TË
- 43 FOTO-ALBUM I KLASËVE
- 50 THËNIET E MATURENTËVE
- 54 VENDI KU LINDA
- 54 LARG FAMILJES
- 54 ULQINI
- 56 NGA ERRËSIRA NË DRITË
- 56 VATËR E DITURISË
- 57 KURANI
- 57 BASHKIMI I SHQIPËRISË
- 58 PRAYING AND SALAH
- 58 A FORGOTTEN FRIEND
- 59 KUJTIMET E BUKURA NUK HARROHEN
- 62 MREKULLITË SHKENCORE NË KURAN

## FJALA E KRYEREDAKTORES

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit Mëshirëbërësit!*

*Falënderimet dhe lavdërimet më të larta i takojnë Allahut të Madhëruar, Zotit të gjithësisë, për mundësitë dhe të mirat me të cilat na furnizon pa fund!*

*Përhëndetjet tona të zemrës ia dedikojmë vullës së pejgamberëve, Muhamedit, paqja dhe mëshira goftë mbi të, familjes së tij fisnike, shokëve të tij besnikë, si dhe të gjithë atyre që dhanë mund për fenë islame!*

*Si një traditë e Medresesë Alauddin, me lejen e Allahut, kjo revistë doli në dritë edhe këtë vit, si një pasqyrim i veprave dhe i punës sonë njëvojçare, përgjatë vitit shkollor 2022/23.*

*Në këtë revistë kemi shprehur shpirtin tonë kreativ, organizimet tona të veçanta dhe bashkëpunimin e ndërsjellë e mjaft të përkushtuar mes nxënësve, drejtorisë dhe profesorëve.*

*Çdo punë që kemi bërë është e dokumentuar në këtë revistë, me qëllim që ky vit mos të mbetet si arkivë vetëm në kujtime, por edhe në raftet librash e revistash nëpër shtëpitë tona.*

*Leximi i kësaj reviste urojmë të jetë frymëzues dhe një reflektim i qartë mbi zellin e këtyre nxënësve dhe punës së tyre!*

*Një falënderim i veçantë për fund i dedikohet Drejtorisë dhe profesorëve, për përkrahjet dhe mundësitë e dhëna për bashkëpunim.*

*Allahun e Madh e lusim që kjo traditë e këndshme e Medresesë të jetë përherë në mendjet e në duart e nxënësve, si një krijimtari letrare e realizuar.*

*Lexim të këndshëm!*

Rumejsa Raçi, 12/3

Boton: ShML "Medreseja Alauddin" Prishtinë

Kryeredaktore: Rumejsa Raçi 12/3

Redaktor: Almir Isaku 12/2

Anëtarë: *Enis Krasniqi 12/1, Ilirik Aliu 12/2, Enes Ramadani 11/1, Reis Mehani 11/2, Ibrahim Mehmeti 11/3, Sead Veseli 10/1, Ensar Veseli 10/2, Albina Bekolli 12/4, Esra Nika 12/4, Dua Çmega 11/4, Lejla Morina 11/5, Esma Sylejmani 10/3 dhe Lumnije Sadiku 10/4*

Lektor dhe redaktor letrar: Besnik Jaha

Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Dizajni: Emir Mehani

E-mail: [redaksia15@hotmail.com](mailto:redaksia15@hotmail.com)

[www.medreseja.com](http://www.medreseja.com)

# SELAMI I FUNDIT



## Ti Medrese

Sot dielli shkëlqen më ndryshe se në ditën e parë, se retë ia kanë mbuluar shkëlqimin, e shiu sa nuk ka filluar të bjerë. Po çuditë shumë: si është e mundur që Diellit t'i humbë shkëlqimi në një vend ku drita e Allahut është e pranishme?! Si është e mundur në një mexh-lis ku engjëjt janë të pranishëm?! Si është e mundur në një vend ku të gjitha të pranishmet janë të mbuluara me nur?! Buzëqeshjet që jepnin selam çdo mëngjes, sot nuk ishin mes nesh. Sot mezi dëgjohej selami nga zërat që dridheshin, gati-gati për të shpërthyer në lot.

Ato ishin bërë gati, ato që na shoqëruan gjatë këtij udhëtimi, për të na e dhënë selamin e fundit. Profesorët dhe profesoret, fazan-kat, ato të vitit të dyta, që mezi prisnin ta merrnin titullin matirante, pa e ditur se aq sa do ta gëzonin, edhe do të mërzhiteshin.

Isha radhitur në atë fushë dy herë, për t'i përcjellë maturantët. Vallahi, më dukej sikur lotët e maturanteve përziheshin me shiun që binte çdo vit në aso dite! E, siç duket, edhe sot shiu do të na i mbuloj lotët tanë.

Përqaftimet më të ngrohta u përjetuan sot. Këshilla të shumta në veshin e secilës që afro-heshim t'ia jepnim selamin e fundit. Aty ku lotët tanë takoheshin me lotët e tyre, në atë moment rrugëtimi për tre vjet më dilte para, e duke e vërtetuar edhe një herë se ato ishin dhe do të mbeteshin vitet më të bukura në kujtesën tonë, shpërtheja edhe më në vaj. Ky kujtim do të jetë argument për ne, në ditën kur do të dalim para Allahut. Elhamdulillah!

Ne u ulëm në këtë mexh-lis, e shijuam kënaqësinë që na e dhuroi ky vend, e rrugëtimi ynë po përfundon sot. E ju që jeni ende këtu, kujtojeni se do t'ju vijë dita kur do të jua japin selamin e fundit edhe ju! Prandaj, ruajeni dhe ta doni njëra-tjetrën vetëm për hir të Allahut, që në Ditën e Gjykimit mos të jemi armike të njëra-tjetrës, por të jemi ato që ishin të sinqerta në shoqëri!

Unë sot po dal nga ti, Medreseja ime, mirëpo me vete do ta marr gjithçka tendën e timen: kujtimet më të bukura të jetës sime.

Medreseja. Shtëpia ime. Familja ime. Kurrë nuk e mendova se do të të thërras kështu. Kurrë nuk mendova se kur do të përmendesh, zemra do të më dridhet. Mirëpo, ja që po ndodh. E kujtoj ditën kur këmba ime shkeli te ti; plot me emocione ndihesha, dhe plot pyetje silleshin në kokën time. Edhe një lloj mërzie, se nga e kishte burimin ende nuk e di. Ditët kalonin, e sa kalonin ato unë edhe arrija ta kuptoja më qartë rëndësinë tënde. Po e kuptoja se sa krenare më bënte fjala kur thosha: "Unë jam medresante". Këtë fjali edhe sa do ta përdor?! A po i vjen fundi?!

Të lutem, o Zot, bëje Medresenë fole të zemrës sime! Të lutem, o Zot, bëje Medresenë qetësi të shpirtit tim! Të lutem bëje të jetë gjithmonë me mua! E si mund të largohet një njeri nga familja e tij?! Si mund ta marrë një rrugë tjetër, e pranë mos ta ketë familjen? Si është jeta kur mallëngjehesh për aromën e shtëpisë, për trokitjen e derës, për bisedat e gjata, për zemrat e bukura të motrave që ishin me ty në çdo çast?! A me të vërtetë do të lë gjithçka, përveç kujtimeve?! A nuk do t'i dëgjoj më fjalët e profesorëve, duke na thënë se ne jeni fëmijët e tyre, jemi e ardhmja, jemi dritat e tyre?! A po përfundon gjithçka?! Si do të dal?! Si do ta mbyll këtë derë?! Ku ta marr atë fuqi të u them lamtumirë?! Ato net që qaja, kur mbyllesha në dhomë, tani dua t'i zhduk fare.

Tani i them vetes: po si munde, si munde kur ishe në fillim, kur kishe gjithë këtë rrugë për të bërë, gjithë këto kujtime për t'i jetuar; si guxove dhe u mërzhite?! Tani sillem e mendohem, dhe çdo gjë më vjen ndër mend. Dua ta ndaloj kohën, e këtë çast përsëri ta jetoj. Çdokund kam një kujtim; kudo më rrethojnë. Sa e fortë qenka zemra, që me këtë mall të jetojë!

Mos më shikoni! Mos më ngushëlloni! As për të më kuptuar mos u mundoni! Mos u mundoni të ma kuptoni dhembjen, se prapë bëhem e fortë, prapë ngrihem! Se një fjalë do ta çoj në vend: amanetin si medresante do ta kryej, dhe fjalët e prindërve tanë nuk do t'i harroj. E, për këtë betohem: si medresantja që nga këtu po largohet sot.





## EDHE PO IKA TI MOS MË LE

Ndonjëherë jeta është aq e bukur me ne, sa na i fal disa njerëz të veçantë. Po, jeta mes jush ishte e ëmbël, dhe i ëmbël qe secili moment e secili kujtim. I ëmbël qe rrethi që e formonim në dhomat e konviktit, e të ëmbla shumë qenë edhe bisedat tona. Të ëmbla ishin edhe bisedat që bënim në vendin ku ishte i vendosur hekuri, duke u kujdesur që dikush mos t'i dëgjonte sekretet tona, që ia besonim vetëm disa mikeve, duke e përgatitur uniformën shkollore që dikur nuk e donim sa e duam tani. Nuk e donim sikurse tani, sepse tani po ia ndiejmë aromën e mungesës. Të ëmbla ishin edhe thirrjet nga fundi i shkallëve, derisa i tërë konvikti e kuptonte se kush ishte zgjuar sot me vonesë, apo se dikush kishte harruar diçka, e që porosiste tjetrën t'ia sillte teksa zbriste shkallëve. Edhe ato orët e studimit, kur nuk donim të shkonim, por edhe kur shkonim e nuk kishim disponim për të mësuar, dhe fillonim muhabet me shoqet e klasës. Edhe ai rendi i gjatë që bëhej në mensë, duke pritur në rend për bukë. Të ëmbla, po, jashtëzakonisht, madje edhe hapat e edukatores teksa vinte në dhomën tonë, e ne duke vrapuar t'i fshihnim gjërat që s'donin të na i shihnte, që mos të merrnim ndonjë vërejtje për mosdalje në orët e liridaljes, të cilat i prisnim me padurim.

Zilja për namazin e sabahut ishte gjëja më e mira, dhe s'do ta harroj kurrë. Të gjitha përnjëherë në sexhde, duke e adhuruar Allahun. E kur çdo harf i fjalës së Allahut dëgjohej e përcillej prej një shoqeje... po ku ka më mirë se kjo!

Ne zgjoheshim herët, duke u përgatitur për shkollë, e duke nxituar që mos të mbyllej dera, e nga nxitimi harronim ndonjë pjesë të uniformës, e që e kishim hekurosuar duke qarë hallet me miket tona. Dhe, pa të gjitha pjesët e uniformës vetëm mund ta shijojë dënimin në mesxhid, ku zakonisht ndëshkoheshim me largim nga mësimi. E, pas dënimin na humbte fryma duke u ngjitur shkallëve për në katin më të lartë. Dhe pasi bënim zgjidhje, kur sapo hynim në klasë, mbusheshim me frymë dhe jetë kur i shihnim ato. Ato që kanë besë dhe që kanë zemër. Ato që kanë sinqeritet dhe që të rrinë pranë edhe në gjërat më të vogla. Ato që i duam shumë. Ajo afërsi që kishim me to, duke filluar nga ajo buzëqeshja e profesorëve dhe profesorehave në korridore, kur i përshëndetnim, na bënte të na shkonte mirë e tërë dita.

Pas krejt kësaj, jam me fat që jam një anëtare e kësaj familjeje. Këto kujtime nuk do t'i harroj kurrë, sado që koha do të mundohet t'i mbulojë me pluhur harrese. Disi e di se këto kujtime nuk do t'i lë të më tretën në burgun e harresës.

Tani ka ardhur koha të shkoj. Edhe po ika, ju mos më lini, sepse, në fund të fundit, ju desha më shumë se gjithçka.



## Ta shohësh perlën e qiellit

E shikoj qiellin e stolisur me yjet e mahnitshme, dhe Hëna është ajo që më josh; e vetmuar dhe e bukur. Krahas yjeve, shkëlqimi i saj është unik.

Buzë liqenit ulem dhe e sodis se si Hëna e përshkon reflektimin me safirin e saj: është mahnitëse mënyra se si drita e saj e mbizotëron qiellin; se si çdo detaj i saj bie në harmoni me perfeksionin!

Me të vërtetë sharmi i saj është surreal.

E si mundet që mos të mrekullohemi nga kjo shndritje që na nxjerr nga errësira?!

Atëherë kur nata kaplon, dhe nata e mbulon qiellin me pelerinën e errët, Hëna shfaqet mbi horizont, dhe sundon në qiellin e pikturuar e spërkatur me yje. Lakmi ia kam Hënës, sa e bukur që është! Ajo qëndron e vetme, krenare, e krekosur e me gjithë atë nur. Ajo nuk përzihet me askënd, rri larg turbulencave. Kur retë e nxjerrin perden e tyre dhe e mbulojnë qiellin, ajo vetëm tërhiqet në rrugën e saj, dhe fshihet pas tyre dhe nuk ngatërrohet assesi. Ta shohësh Hënën, t'i qetëson sytë, e shpirtit i jep prehje...

Gjithë kjo bukuri, a thua si do të ndihemi kur ta shohim bukurinë e Krijuesit të saj?! Zot, na e bëj risk!

*Esma Sylejmani 10/3*

## HANA

Hanë, a s'u lodhe prej meje, te ti tu u anku?! Se çdo fjalë e jemja besoj që edhe ty t'ka rëndu. Ndjenjat e mia veç m'vyn me dal në dritare me t'i tregu. Se ndriçimi që ti ma jep m'ban dritë në zemër mu. Hanë, ti je mbet e vetmja shpresë për mu, sesa herë kam dasht me qenë e lumtur, ty t'kam shiku. Ti je e veçantë n'mes të gjithë atyre yjeve prapë t'u shndrit. Se s'është asgjë si ti, ti je ajo e cila vetmisë i jep dritë. A si del boll yjeve n'qiell? Se edhe njerëzit në tokë janë t'u u anku. Miliona yje m'u mledh, prapë si ti Tokën nuk munden me ndriqu. M'ke dhanë vetëbesim që duhet veten me vlerësu, se gjysmë apo e plotë, askush përveç vetes s'ka me m'plotësu.

*Anisa Banjska 11/5*



## NOSTALGJI

Shi. Rrugë e lagur. Rrugëtim i pambaruar, i lënë përgjysmë. Trup e shpirt shijojnë pikat e flladshme, pikat e shiut të kësaj dite vere. Lumturi e çastit, e shoqëruar me kujtime. Nostagji. A e di? Kujtimet rrojnë aq sa duam, dhe jetojnë momente të ngjashme me to. Prandaj, edhe ky trup, ky zog i lirë, sot ka dalë dhe vrapon mes shiut, pavarësisht të gjithave; sepse kujtimet e bukura me ty, buzëqeshjet plot jetë nën pikat e shiut, e flladitin shpirtin. E shuajnë mallin dhe e ngjallin nostalgjinë. Shpirt i lirë, lumturi.

*Rumejsa Raçi 12/3*



## KAM MALL

Ditët kalojnë, e malli për ty s'u shua asnjëherë. Lotët për ty s'kanë të ndalur. Aroma jote ndihet në çdo vend. Rrugët tani janë errësuar, ngase ti nuk je më që t'i ndriçosh me pamjen tënde engjëjlore. Madje edhe lulet janë vyshkur nga mungesa jote.

Ndërsa unë, unë vdiqa dhe u varrosa me ty. Çdo ditë pres me mall te dera, se ti prapë do të kthehesh. Brenda meje ekziston ndjenja se një ditë do të bashkohemi sërish, dhe e pres me mall.

Çdo ditë i kujtoj ditët tona të lumtura, që ishin të pambaruara derisa ti ishe në mesin tonë. Mirëpo tani as dielli nuk lind më. As lulet nuk lëshojnë aromën e tyre... Dhe, e di pse. Sepse kanë mall për aromën tënde. Më beso, fjalët nuk po formulohen vetë! Ato e kanë buri-min nga dhembjet e zemrës, e që çdoherë shoqërohen me lot. Sikur edhe një jetë të tërë të shkruaja për ty, nuk do të mjaftonte për ta përshkruar mungesën tënde. Mirëpo, unë po e lë me kaq, ngase shpresoj të të takoj sa më shpejt të jetë e mundur. Eh..., takimi ynë!

*Saime Hoti 11\5*



## JETA

Njeriu lind, rritet, zhvillohet, dhe në fund vdes.

Mirëpo momenti i vdekjes varet nga jeta, se si e kaluam, se si jetuam, se si e shfrytëzuam dhe se si ishim në raport me Krijuesin dhe krijesat e Tij.

Jetën e jetojmë duke e zbatuar dhe duke e respektuar fjalën e Allahut, që është dritë në errësirë, dritë në tunelin jetësor.

Kam kuptuar se jeta është si një tunel, herë i ndriçuar e herë i errësuar.

Dikujt në dritë i shfaqet errësira, e dikujt në errësirë i shfaqet drita.

Mirëpo, mos të habitemi, por të jemi të përgatitur, se me të vërtetë errësira më shumë zë hapësirë. E pastaj, ku do të mbetesh ti?!

E gjatë rrugës do të hasim edhe në pemë, degët e të cilave pikojnë mjaltë.

Ama..., vetëm pika janë ato, pika të rralla e të vogla, dhe tërheqëse.

Dhe poshtë pemëve gropa e humnera, e në ato humnera egërsirat, duke pritur prenë e tyre.

E nëse ti lakmon, mos tento t'i shijosh, sepse në humnerë do të përfundosh!

E po deshe të jesh i fituar, gjatë rrugës duhet duruar.

Dhe ti, o njeri që nuk durove!

Që Krijuesin tënd e harrove!

Dhe për një pikë mjaltë veten e mashtrove!

Edhe pse më herët edhe mua më paralajmërove!

Mua më këshillove, e vetë lakmove!

Pse ashtu, vallë, ti ndryshove?!

“O Zot, mos na i ndrysho zemrat tona, pasi në rrugë të drejtë na i udhëzove!”

*Eljesa Maxhuni 11/4*

## MOS!

Mos! Mos e rrëzo shtyllën e fesë! Mos e humb çelësin e dyerve të Xhenetit! Mos e fshij vulën e besimit tënd! Mos, se do të pendohesh! Do të pendohesh deri në pikën e fundit, dhe do ta shohësh se ke pasur zgjidhje, dhe se ajo zgjidhje e atyre brengave, pikëllimeve e problemeve ka qenë shumë e lehtë! Ndoshta më e lehtë sesa e ke menduar! Ajo zgjidhje ishte namazi. Po, namazi. Ai që porsa fillon ta bësh, ta qetëson shpirtin, të bën njeri tjetër, e të çrrënjos ngulitjet e atyre dëshpërimeve e pikëllimeve!

Ke për të parë dhe vetë se po ata që po i largohen namazit, po mbesin me sytë hapur, dhe asnjëherë nuk po ngopen me begatitë e përkohshme të kësaj bote. Sepse po e lënë pas shpine atë të mirë që i obligoi Krijuesi i tyre, dhe po i vihen pas kësaj botë kalimtare, në të cilën asnjëherë lumturia nuk zgjat përgjithmonë.

Atëherë, pra, mundësoja ballit tënd ta puthë dheun dhe ta provojë sexhden! Le ta ndiejë kënaqësinë e shijes së përluljes! Mundësoja vetes mbrojtjen nga dënimi i pandërprerë! Nëse jo tani, kur?!

*Medina Bajgora 11/5*







Më ka rastisur ta dëgjoj një fjali “Koha është flori”. Mendoja me vete: sa thënie e mirë dhe domethënëse. Dhe, u thellova në nxjerrjen e kuptimit, e pastaj e pashë se nuk qëndronte ashtu siç e kisha menduar më parë. Floriri është një gjë që mund të humbë, dhe përsëri mund të fitohet, ndërsa koha është një gjë që, nëse humb, nuk kemi mundësi ta rikthejmë atë. Koha që ka një njeri është e njëjtë për të gjithë. Të gjithë e kemi ditën dhe natën, mirëpo të gjithë nuk e kemi modelin e njëjtë të shfrytëzimit. Ne do ta jepnim gjithë pasurinë në këmbim të kthimit të kohës, mirëpo nuk to të ndodhte. Koha është si ajo mundësia për ta shfrytëzuar, mirëpo nga pakujdesia e kemi lënë pas dore, dhe kështu na ka ikur pa e shfrytëzuar. Më pëlqen shumë një proverb që thotë se “e shkuara është histori, e ardhmja është një mister, ndërsa e sotshmja është një dhuratë.”

Nëse ndokush prej nesh e neglizhon kohën, e ka neglizhuar një mundësi të veten për të bërë diçka në jetë, për ta arritur kënaqësinë shpirtërore, për të fituar në mënyrë të ndershme, dhe të keqen, apo të pandershmen, për ta ndaluar me atë që mundet. Koha e lirë e mbyt karakterin e njeriut. Kur një njeri thotë se ka kohë të lirë, nuk ka ç’ të bëjë, e qon kohën dëm, ai njeri ngjan sikur me një person që ka shumë pasuri dhe e humb atë në një çast, e pastaj e kupton rëndësinë e saj, mirëpo tani është shumë vonë, sepse pasuria shkoi. Njësoj është edhe me kohën, sepse ajo është e çmuar, dhe është e nevojshme ta shfrytëzojmë në maksimum. Mendoj se koha është një amanet prej Zotit, që atë ta shfrytëzojmë në të mira, dhe asesi në punë të kota e për të cilat do të pendohemi. Prandaj, le ta ruajmë amanetin, dhe mos ta keqpërdorim, sepse për diçka që nënvlerësohet, do të pendohemi më vonë për çfarë jemi bërë.

Adnan Smajli 12/2

# PËR TY HAFIZE E KURANIT

Për ty, që Kurani qëndron në zemrën tënde. Për ty që Allahu të zgjodhi të jesh në këtë rrugëtim. Përgëzohu! Dhuratën më të çmuar ta ka dhënë.

Prej gjithë këtyre njerëzve e zgjodhi zemrën tënde që të bartet fjala e Tij. Ty ta ndriçoi fytyrën me nurin e imanit, dhe Kuranin e bëri pjesë të pandashme tënden.

Motër e dashur, tashmë nuk je e njëjta. Tashmë je e veshur me cilësinë e bartëses së Kuranit. Tashmë duhet të jesh shembulli që të tjerat duhet ndjekur; duhet të jesh model dhe Kuran i gjallë në këtë Tokë.

Ngase ata që fort u kapën pas fjalës së Allahut, zemra e tyre nuk lumturohet vetëm se me të, e ditët nuk zbukurohen vetëm se me leximin e tij, dhe ai u është bërë qetësi e shpirtit.

Prandaj, të them se do të vijë dita që do të të mungojë ai memorizim, sepse tashmë je e përmbushur. Kur të zgjohesh në një nga mëngjeset, dhe nuk do ta kesh një ajet të ri, sepse pikërisht në gjoksin tënd janë të ruajtur 6236 ajete. 6236 ajete që zemrën tënde e ndryshuan, ndërsa qenies ia dhanë emrin e nderuar: "HAFIZE E KURANIT"!

Në këtë rrugëtim mund të kesh vështirësi, po assesi humbje, mund të dështosh, po do të ngrihesh më e fuqishme, si dhe mund të kesh hidhësi nga zhgënjimet, po në fund do ta shijosh ëmbëlsinë e fitores së madhe.

Atëherë kur zemra të jetë nën vorbullën e shqetësimeve, të brengave të dunjasë, dhe kur brenda vetes thua se nuk do t'ia dalësh, kujtoje premtimin që ta dha Krijuesi yt! Kujtoje ajetin kuranor që e bën shpirtin tënd të pushojnë në caktimin e Allahut!

*Imrane Zariqi 12\4*





## MË MUNGON

"Të solla lule", më the kur erdhe. Të kisha harruar. U bë kohë që s'kujtohem! E mbaje mend fare mirë se, kur folëm herën e fundit, ti s'ishe fare mirë! Po të dridheshin duart ndërkohë që po më flisje. Ç'të rëndonte mbi to? Faji? Ndoshta gabimet!

Gabove shumë për ta kuptuar se ç'ishte e drejtë për ty! T'u desh shiu për ta kuptuar se si lulëzojnë lulet! T'u deshën furtunat për të të verbuar drita e diellit! T'u desh drita, për ta dalluar errësirën, dhe t'u desh e keqja për ta dashuruar të mirën!

E hodha shikimin përtej dritares, dhe si vegim m'u shfaqën të gjitha gjërat që kanë ndryshuar.

Tashmë perëndimet e kanë marrë pamjen tënde, e paragrafët nuk ma lumturojnë më mëngjesin. As vaktet nuk i ndajmë më bashkë. Ushqimi im i preferuar ka ndryshuar shije, dhe unë u bënë ditë që nuk ha më. Ëndrrat u bë kohë që janë kthyer në makthe, e librat e mi të preferuar kanë filluar të ndryshojnë histori, sikurse edhe përqafimi im i preferuar ka muaj që më mungon.

Të kujtoj ende në çdo rrugë që ecëm të dy, dhe filloj të të flas, sepse e ndiej sikur fshihesh diku nëpër gjethe aty skaj, pas ndonjë peme a guri. Tani yjet e kanë botën time, e qiell i ruan kujtimet e mia. Dielli ia fali Hënës portretin që doja ta shikoja gjithë jetën.

"Më mungon", të thashë në telefonatën e fundit, teksa buzëqeshja jote më bënte të ndihesha e sigurt.

"Qielli duket bukur", thosha, kur e shikonim të dy. "Qielli duket bukur", po them edhe sot, sepse atë e ke zbukuruar ti.

Shpresoj mos të kesh asnjë dhimbje në shtratin tënd të ri. Dhembjen tani e mbaj unë për ty.

"Më mungon", të thash kur për herë të fundit e preka dheun që rëndonte mbi ty, që s'do të të takoj kurrë më në këtë jetë.

Sara Halili 12/4



# MËSIMI I KURANIT NGA PERSPEKTIVA

Ishte pranvera e vitit 1942. Lufta e Dytë Botërore kishte marrë hov në tërë kontinentin e Evropës, duke u shtrirë dalëngadalë edhe në kontinentet e tjera.

Abdullahu i vogël, që kishte veshur pantallona të zhguntë, e hapi me vrap derën e shtëpisë, dhe kërkoi opingat e tij për t'iu bashkuar moshatarëve të tij, që ia kishin mësyre mejtepit të xhamisë në fshatin e afërt. Në dorë mbante disa fletë, të cilat ishin të plotësuar me shkrim dore. Shtatshkurtër, mirëpo ecte me hapa të shpejtë, e disa herë i duhej edhe të vraponte, sepse fëmijët e tjerë, më të rritur, po ecnin shpejt e me hapa më të mëdhenj. Në oborr të xhamisë po i priste imami i fshatit, i cili mbante çallmë mbi kokë. Ai kishte veshur një xhybe, e që po ashtu i jepte hijeshi shtatit të tij. Buzëqeshja e tij ishte shumë e ëmbël, mirëpo njëkohësisht edhe mërrulet e tij e bënin të dukej paksa hijerëndë. Çdo ditë Abdullahu dhe moshatarët e tij i ndiqnin mësimet te hoxha, duke filluar nga Elifbaja, Subhaneja, Elhami, Tebarja, Kasemi, Vizarja, sipas një metode që ishte përcjellë qysh nga gjeneratat e mëhershme. Nuk kishin karrige e as banka, por vetëm disa "lahre". Hoxha i thoshte me zë shkronjat: E, I, U, Be, Bi, Bu, e fëmijët i përsërisnin pas tij, sikurse edhe vokalet e njohura si "hareqe", me emërtime; Estre (I), Otro (U), Ystyna (E) etj.

E, Texhvidi ishte mësimi kyç, të cilin Abdullahu me shokët e tij e kishin obligim ta përsërisnin çdo të enjte, mësim ky i njohur me emrin Bashtan, nga ato të Nunit me Xhezëm, Meddat, me dy mikdar elif dhe me katër e me gjashtë mikdar elif.

Ata e lexonin Kuranin, e hoxha i dëgjonte. Nëse ndonjëri prej tyre nuk angazhohej sa duhej, me siguri se edhe "fallaku" nuk mungonte. E, njëherë një të tillë e kishte përjetuar edhe Abdullahu, sepse nuk e kishte mësuar "dersin" e radhës, si shkak i neglizhimi të "dersit", për lojë fëmijësh.

Sot Abdullahu, para nipave e mbesave, i përmend me nostalgji shumë prej moshatarëve të tij me të cilët së bashku e kishin mësuar leximin e Kuranit para hoxhës. Disa prej shokëve të tij të Kuranit ishin: Avdyli, Haliti, Islami, Hafizi, Tafa, Salihu, Behxheti, Selimi, Ademi, Nuhu, Imeri, Muharremi, Hajdari, Beshiri, Maliqi etj.

Sot, pas më shumë se 80 vjetësh, në mijëvjeçarin e tretë, Esmë, mbesa e Abdullahut, po i ndjek mësimet e Kuranit në Medrese. Ajo është në klasën e 11-të, ndërsa çdo mëngjes e vesh uniformën e shkollës, e vendosë shaminë mbi kokë, i merr librat dhe së bashku me babanë e saj e marrin rrugën drejt Medresesë. Me te hyrë në shkollë, ambienti i ngrohtë i shkollës i bën menjëherë për vete. E, Esmë aty takohet me shoqet e saj, të cilat tani bashkë janë duke marrë mësimet Kurani në bankat e Medresesë. Klasat e pastra, me banka e karrige moderne, e mbi të gjitha pajisjet e konkretizimit shumë bashkëkohore, sigurisht se ofrojnë mundësi më të mira. Secila nxënëse e ka librin përkatës, Kuranin, po edhe fletoren e punës. Tabela e mençur e lehtëson jashtëzakonisht mësimin, duke e mundësuar leximin e drejtpërdrejt prej shumë lexuesve të njohur të Kuranit. Ajo sot do ta mësonte rregullën e Mimit me sukun, se si duhej të lexohej



# E GJYSHIT TIM DHE PERSPEKTIVA IME

kjo shkronjë me rregull. Profesoresha e saj e Kuranit, po, profesoresha, se tani Kuran mes nesh mund të na mësojnë edhe femrat, me kujdes ia sqaron çdo gjë, dhe i pyet me radhe nëse e kanë kuptuar të gjithë. Pasi ora po afrohej kah fundi, ato e dëgjonin me ëndje leximin e disa pjesëve të Kuranit prej lexuesve të njohur të Kuranit. Krejt në fund, profesoresha i porositi që, nëse kanë ndonjë pyetje, ato mund t'i drejtoheshin asaj edhe nëpërmjet telefonit, apo grupeve në "Class room".

Atëherë dhe tani, për të vjetër e për të rinj, leximi i Fjalës së Allahut ka zënë vend të posaçëm në zemrat e njerëzve në këto troje, për shekuj me radhë, dhe është mësuar vazhdimisht.

Vitet e komunizmit ishin më të rëndë, dhe kishte presion të madh kundër atyre që dëshiron ta mësonin Kuranin. Kurse në këto ditë lirie mësimi i leximit të Kuranit është zgjeruar, dhe pothuajse në çdo xhami, në Institute dhe Qendra për mësimin e Kuranit përmendësh, vazhdon të mësohet e të lexohet Fjala e Allahut-Kurani fisnik.

Secili duhet ta ketë të qartë se me mësimin e Librit të Allahut asnjë popull nuk do ta humbë të ardhmen e vet, sepse kështu na ka mësuar edhe i Dërguari i Allahut - Muhamedi, a.s., kur thoshte: "Allahu i ngre lart me këtë Kuran shumë popuj, e shumë të tjerë i ulë poshtë."

Vetëm Zotin e Gjithëmëshirshëm e lusim të na e bëjë Kuranin të dashur për zemrat tona, si dhe dritë e shpëtim në rrugët e jetës sonë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër!

*Suhejla Çunaku 11/5*

# ATEIZMI,

RRUGËT DREJT TIJ, RREZIKU DHE SI TË BALLAFAQOHEMI ME TË

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

الْحَمْدُ لِلّٰهِ نَحْمَدُهُ وَنَسْتَعِينُهُ وَنَسْتَغْفِرُهُ وَنَعُوذُ بِاللّٰهِ مِنْ شُرُورِ اَنْفُسِنَا  
وَمِنْ سَيِّئَاتِ اَعْمَالِنَا مَنْ يَهْدِهِ اللّٰهُ فَلَا مُضِلَّ لَهُ وَمَنْ يَضِلَّ فَلَا هَادِيَ  
لَهُ وَاَشْهَدُ اَنْ لَا اِلَهَ اِلَّا اللّٰهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَاَشْهَدُ اَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ  
وَرَسُولُهُ

**L**avdia i takon Allahut, xh.sh.! Atë e lavdërojmë, Atij i kërkojmë ndihmë, dhe vetëm prej Tij falje kërkojmë! Mbrojtjen e kërkojmë tek Allahu, nga sherret e vetvetes sonë dhe nga të këqijat e veprave tona! Atë që e udhëzon Allahu, s'ka kush ta devijojë, dhe atë që e devijon Allahu, s'ka kush ta udhëzojë. Dëshmojmë se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Vetmit e të Pashoqit, dhe dëshmojmë se Muhamedi është robi dhe i dërguar i Tij!

Tema që kam përzgjedhur për të shtjelluar gjatë kësaj ligjërata, e që mendoj se duhet të jetë prej temave më të përfolura gjatë kohës bashkëkohore, për shkakun e ekspozimit të çdo të mituri dhe të riu nëpër brumin e njolllosur e të fshehtë të rrjeteve sociale, është tema rreth ateizmit. Me fjalë të tjera, do të flas se ç'është ateizmi, cilat janë rrugët që e dërgojnë një njeri drejt ateizmit, rrezikun e ateizmit dhe mënyrën se si t'i shmangemi atij.

## Ç'është ateizmi?

Rreth përkufizimit terminologjik për ateizmin themi se: Ateizëm është mohimi i ekzistencës së Zotit. Kjo do të thotë se ateistë janë ata që nuk besojnë në ekzistencën e Zotit të Madhëruar, e aq më pak ta pohojnë Njeshmërinë e Tij në zotim e adhurim.

Ne si myslimanë besojmë me plot bindje se Allahu është Një, i Vetëm dhe i Pashoq. Për këtë gjë kemi argumentet e transmetuara (Kuranin dhe Sunetin), mirëpo edhe argumentet logjike që dëshmojnë për ekzistencën dhe Njeshmërinë e Tij.

Allahu është i Pari, pa fillim, para të Cilit s'ka pasur asgjë, dhe është i Fundit, pa mbarim, pas të Cilit nuk mbetet asgjë. Pushteti i Tij është i plotë, e urdhri

i Tij është i zbatuar, si dhe bukuria e Tij është e përsosur. Në këto çështje nuk duhet të ketë aspak dyshim.

Ateizmi ka qenë edhe në të shkuarën, mirëpo kanë qenë shumë numër i vogël ata që e kanë mohuar Zotin dhe Cilësitë e Tij. Një nga më të njohurit ishte Faraoni, i cili është përmendur shpesh edhe në Kuran, e i cili ka thënë:

" قَالَ فِرْعَوْنُ وَمَا رَبُّ الْعَالَمِينَ "

"Faraoni tha: " E ç'është Zoti i botëve?". (Shuara: 23)

Mirëpo, hovin më të madh ateizmi e mori në fillim të shekullit të tetëmbëdhjetë, kur shkenca dhe teknologjia ishte në zhvillim e sipër. Në këtë kohë u shfaqen shumë ideologji me bazë në shkencë, duke lënë anash fenë me pretekstin se feja ishte ajo që linte prapa dhe e humbte humanizmin. Darvini e filloi me teorinë e tij rreth zanafillës së universit, e cila binte ndesh direkt me librat fetarë islam dhe të krishterë. Pastaj Niçe, i cili tha se "Feja është një dogmë e kotë dhe krim ndaj njerëzimit". Marksi u shpreh me teorinë e tij të njohur, se nuk ka Zot, dhe se jeta është materie, e feja është opium për popullin. Kështu që, secili dha idetë e veta, duke i hapur rrugë përhapjes së ateizmit me tepër sesa kishte qenë ndonjëherë.

Këtu mund t'i përmendim edhe dy pika të shkurtra, e të cilat u përdorën në bindjen e njerëzve se ateizmi ishte rruga e duhur:

1. Kisha evropiane-ishte nga shkaktarët direkt dhe indirekt që i shtynte njerëzit drejt ateizmit. Asokohe klerikët fetarë të kishës shtonin shumë trillime dhe gënjeshtër: ngritja e Isait, a.s., nga shkalla e njeriut në shkallë të perëndisë, mëkatet dhe faljet, kufizimet në të lexuar dhe të zhvilluar të mendjes etj. Këto i shtynin njerëzit të mos besonin, dhe të vinin në diskutim madje edhe ekzistencën e Zotit.

2. Dhuna dhe padrejtësitë kapitaliste-Pas largimit të rendit feudal dhe vendosjes së kapitalizmit njeriu pati shpresa se do të largoheshin padrejtësitë, mirëpo ato mbetën të njëjta për punëtorët, thuajse siç edhe kishin qenë. Dhe, kështu e shfrytëzuan këtë pikë për të thënë se, po të kishte Zot, atëherë pse disa të vuajnë, e disa jo?!



وَقَدَّمَ كُرُوءَ أَمْكَرُهُمْ وَعِنْدَ اللَّهِ مَكْرُهُمْ وَإِنْ كَانَ مَكْرُهُمْ لِتَزُولَ مِنْهُ الْجِبَالُ

*"Dhe ata ngrenë kurthet e tyre, mirëpo kurthet e tyre janë në Dorë të Allahut, edhe në qofshin kurthet e tyre aq të fuqishme sa t'i bëjnë malet të lëvizin nga vendi." (Ibrahim: 46)*

Në Kuran kemi disa ajete ku Allahu flet për shpifjen e atyre që pretenduan se Zoti ka djalë:

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ﴿٨٨﴾ لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ﴿٩٨﴾ تَكَادُ السَّمُوتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ﴿٩٩﴾ أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ﴿١٩﴾

*"Ata thanë: "I Gjithëfuqishmi ka fëmijë". Ju (jobesimtarë) vërtet sollët një fjalë shumë të shëmtuar. Aq të shëmtuar sa gati u copëtuan qiejt, gati pëlciti Toka, dhe gati u shembën kodrat nga ajo (fjalë). Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë." (Merjem: 88-91)*

Përderisa vetëm t'i përshkruash Allahut fëmijë është kaq e rëndë, atëherë paramendojeni rreth atij që e mohon komplet ekzistencën e Tij?!

Maurice Blondel thoshte: "Nuk ekzistojnë ateistë me kuptimin e plotë të fjalës.". Ajo kishte për qëllim ndarjen e ateistëve, e që është se:

1. Nuk besojnë fare në ekzistencën e Allahut;

2. Janë agnostikë (të dyshimtë) se a ekziston Allahu apo jo.

Ndërsa, një grup tjetër e pranojnë ekzistencën e Zotit, përveçse thonë se Zoti ka hequr dorë nga de-tyra e Tij, dhe është zhdukur!

Sa fjalë dhe pretendime të këqija që janë këto!

## Shkaqet që çojnë drejt ateizmit

Pasi folëm se ç'është ateizmi dhe si ndahet ai, tani do të diskutojmë rreth shkaqeve që një njeri e shtyjnë në një humnerë të tillë.

Shkaku i 1-rë: Inferioriteti kundrejt "civilizimit": Shumë prej të rinjve bien pre e kësaj, duke qenë të mahnitur nga bota Perëndimore, pas së cilës edhe rendin qorrazi.

Shkaku i 2-të: Moskuptimi i duhur i paracaktimit hyjnor- Kadasë dhe Kaderit.

Shkaku i 3-të: Kurthet e jobesimtarëve: të cilët përdorin shumë metoda për ta lëkundur besimin në zemrat e myslimanëve, dhe për t'ua bërë lavazh trurin. Allahu në Kuran thotë fjalë rreth planeve famëkeqe të armiqve:

وَقَدْ مَكَرُوا مَكْرَهُمْ وَعِنْدَ اللَّهِ مَكْرُهُمْ وَإِنْ كَانَ مَكْرُهُمْ لِتَزُولَ مِنْهُ الْجِبَالُ

"Dhe ata ngrenë kurthet e tyre, mirëpo kurthet e tyre janë në Dorë të Allahut, edhe në qofshin kurthet e tyre aq të fuqishme sa t'i bëjnë malet të lëvizin nga vendi." (Ibrahim: 46)

Shkaku i 4-të: Dhënia pas dëshirave, epsheve dhe shfrenimit moral: Ateizmi dhe shthurja janë dy gjëra që shkojnë shumë mes vete, pasi te secila nuk ka më gjëra të ndaluara dhe të lejuara.

Shkaku i 5-të, dhe i fundit: Mendjemadhësia: Mendjemadhësia është shkaku më i rëndësishëm, e i cili ka të bëjë më ateizmin. Në fakt, mendjemadhësia është shkaktar i shumë e shumë mëkateve dhe i fryteve të këqija. Pejgamberi, a.s., në një hadith ka thënë: "Në Xhenet nuk do të hyjë asnjë që në zemrën e vet ka mendjemadhësi, madje edhe sa një grimcë." (Transmentues: Myslimi). Ndërsa, në një tjetër hadith është shprehur se: "Mendjemadhësia është përbuzje e së vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve të tjerë." (Transmentues: Myslimi).

## Parimi i dyshimit dhe disa pretendime të ateistëve, si dhe sqarimi i tyre

Dyshimi është pjesa bërthamore e ateizmit, dhe është sikurse rrënjët e një peme. Gjithçka që ndodh në ateizëm është si pasojë e lindjes së dyshimeve, e të cilat janë të padobishme, mirëpo janë aq bindëse dhe të mjaftueshme për ta, sa edhe për ta mohuar ekzistencën e Allahut, Krijuesit të tyre.

Sigurisht se është për t'u çuditur edhe me faktin se, edhe pse parimi i dyshimit është i rëndësishëm për ta (ateistët), përsëri janë pikërisht ata që bien ndesh me të, sepse nuk lejojnë që pastaj ndokush të ketë dyshim në parimet e tyre, e që ata tentojnë t'i mbrojnë me fanatizëm. Sidoqoftë, ky parim themi se është i gabuar dhe i papanuar logjikisht. Le ta marrim një shembull praktik, për ta kuptuar më lehtë idenë e dyshimit tek ateistët! Ata thonë se çdo njeri që i beson disa të vërtetave, ai duhet të dyshojë në lidhje me saktësinë e tyre, e pasi të ketë dyshuar, t'u besojë atyre. Kjo është sikur të thuhet se: ti duhet ta pish një helm, në mënyrë që ta gëzosh efektin pozitiv të kundërhelmit.

Dy nga pretendimet e tjera të ateistëve janë:

1. Ata thonë: "Nëse themi se ekziston Krijuesi-Allahu, atëherë, nisur nga ky parim, kush e krijoi Allahun?". Këtë parim e rrëzojmë poshtë me faktin se ateisti në fillim e pranojnë se Allahu është Krijuesi, dhe se, si ka mundësi të pyesë se kush e krijoi Krijuesin? Kjo është pyetje pa bazë logjike.

2. Ose thonë: "A mundet Zoti ta krijojë një shkëmb aq të madh, sa mos të mundet ta ngrejë si peshë?". Edhe këtë parim e hedhim poshtë me faktin se cilësitë dhe fuqia e Zotit nuk është e kufizuar; Zoti nuk mund të ishte Ai që është nëse nuk i ka aftësitë dhe cilësitë e plota.

## Mbrojtja nga rënia pre e kurtheve të ateizmit

Mënyrat për t'u ruajtur nga ateizmi janë:

1. Kushtimi i vëmendjes ndaj Librit të Allahut dhe Sunetit të Pejgamberit, a.s., duke i lexuar dhe duke i medituar versetet.

2. Përpjekja e vazhdueshme për ta ripërtërirë besimin dhe për ta shijuar ëmbëlsinë e tij. Kjo arrihet duke medituar rreth cilësive të Allahut, përsosmërisë së krijimtarisë së Tij dhe në falje të namazeve nafile gjatë natës.

3. Kultivimi i besimit të drejtë në zemrat e njerëzve, e sidomos në çështje të ndjeshme, siç është Kadaja dhe Kaderi.

4. Forcimi i ndjenjës së besimit, si dhe krenaria me faktin se Allahu na ka nderuar të jemi myslimanë/e, duke na mëshiruar me besim.

5. Zbatimi i të gjitha porosive pejgamberike në lidhje me këtë temë.

Dua ta përmyll temën me këtë pikën e fundit, duke e përmendur një hadith të Pejgamberit, a.s., i cili transmetohet prej Ebu Hurejres. Pejgamberi, a.s., ka thënë: "Ka për të ndodhur që njerëzit do pyesin duke thënë: "Nëse të gjitha krijesat i ka krijuar Allahu, po Allahun, kush e krijoi?". Nëse dikujt prej jush i vjen ndërmend kjo pyetje, le të thotë: "Unë i kam besuar Allahut!". (Hadithin e transmeton El Harith El Esharij, dhe mban numrin 2863).

Allahu na e mundësoftë të kemi edhe shumë e shumë ligjërata rreth temave të hairit për ne! Kjo ishte e gjitha që kisha përgatitur për këtë temë. Allahu na nderoftë dhe na bashkoftë në xhenetet e Tij! Allahumme, amin!



## MIRË SE ERDHËT NË MEDRESE

Më datë 19.10.2022 në Medrese u mbajt programi mikpritës për vajzat e klasave të 10-ta.

Program u shfaq pas një kontributi të madh që dhënë vajzat maturante dhe vajzat e vitit të 11-të, në mënyrë që t'i mirëprisnin e t'i bënin të ndiheshin mirë dhe komod vajzat e reja në ambientet e Medresesë.

Programi u nis me fjalën e Allahut, me disa ajete të përzgjedhura nga Kurani fisnik. Pas këtij fillimi të ëmbël, që i dha atmosferës ambientit dhe publikut bukuri, hare dhe qetësi shpirtërore, më pas doli drejtor Fadil ef. Hasani, me një fjalë rasti, duke filluar me një shtjellim të shkurtër rreth ajeteve të përzgjedhura dhe hijeshisë që ka çdo fjalë e Allahut të Madhërishtëm. Më pas pati rastin të gjejë fjalët më të mira të mundshme për vajzat, përkatësisht nxënëset e reja, duke e përmblyllur me dërgimin e mesazhit se vetëm në Medrese do t'i gjejnë mësimet e dëshiruara dhe edukimin e mirëfilltë, në mesin e një familje të dytë, të një shtëpie të dytë. Drejtori u premtoi mbështetje për të arritur rezultate, dhe ua uroi një fillim dhe vit të mbarë!

Pas drejtorit fjala i takoi kujdestarit të klasës 10/3 profesorit Shkëlzen Hoxha, i cili duke mos dashur ta zgjatë shumë fjalimin e tij, me disa fjalë të thukëta arriti ta përmbledhë qëllimin e programit, duke ë uruar suksese të mëtutjeshme për secilën nxënëse.

Për fund fjala i kaloi kujdestares së klasës 10/4, profesorëshës Valbona Asllani. Përmes fjalimit të saj ajo arriti t'i thurë disa vargje rreth rëndësisë së fjalës së Allahut, përvojës ndër vite, rëndësisë së Medresesë, ngrohtësisë që na ofron, lidhjes dhe mbështetjes që ekziston mes njëra-tjetrës, duke përfshirë sigurinë dhe komoditetin, ashtu si me familjen, epo, sigurisht duke i konsideruar pjesëtarët e Medresesë si familje e dytë.

Me përfundimin e fjalimeve radhua erdhi disa ilahive të përgatitura nga kori i vajzave, e pastaj programi vazhdoi me poezi humoristike dhe sllajde humoristike argëtuese. Vajzat patën edhe rastin të argëtohen me përzgjedhjen e disa lojërave atraktive.

Dhe, pas gjithë pikave të përmendura më lart, u prezantua edhe një ese, me titullin: "Në vatrën e dijes", ku përveç Medresesë u përshkruan edhe dija edhe mësimet për jetë që merren aty. Më pas kori i prezantoi edhe një ilahi, dhe si përfundim programi u përmbyll me një poemë (monolog) të shkruar bukur, po ashtu dedikim Medresesë, duke filluar me përjetimet si nxënëse, dhe duke përfunduar me pikëllimin e ndarjes, pas përfundimit të misionit të marrjes së dijes ndër vite.



## MANIFESTIMI I DITËLINDJES SË TË DËRGUARIT A.S.

Më datë 20.10.2022, në vazhden e aktiviteteve të shënimit dhe të përkujtimit të ditëlindjes së Muhammedit, a.s., Medreseja organizoi një manifestim për të përkujtuar udhëzuesin, përgëzuesin, lajmëtarin, përmirësuesin e zemrave, peygamberin tonë, Muhamedin, a.s.

Me këtë rast në programin e organizuar prej nxënësve të Medresesë u kënduan salavate dhe një pjesë nga mevludi. Programi i u organizua nga paralelja e djemve, me mbështetjen e pakursyer të Drejtorisë së shkollës dhe stafit të caktuar arsimor përgjegjës të maturantëve.

Programi u hap me recitimin e bukur të Kuranit famëlartë, paraqitje që i freskoi dhe i qetësoi zemrat e të pranishmëve. Pas recitimit, u kënduan salavate nga kori i nxënësve, e më pas të pranishmëve iu drejtua me një fjalë rasti drejtori i shkollës, Mr. Fadil ef. Hasani, për ta përkujtuar vlerën dhe rëndësinë e madhe të këtij muaji. Njëkohësisht drejtori uroi mirëseardhje edhe për gjeneratën e re të medresistëve, dhe me këtë rast atyre u dha mesazhe dhe këshilla të dobishme, duke u ofruar mikpritje dhe ngrohtësi në

shkollën që ata e kanë zgjedhur. Ndër të tjera ai tha se “e keni zgjedhur shkollën më të mirë, për t’i mësuar mësimet më të dobishme për jetën tuaj, prandaj ju uroj një fillim të mbarë, suksese dhe mbarësi, si dhe mirëqenie për ju dhe familjet tuaja...”.

Pastaj, atmosferës i solli hare edhe Kori i Medresesë, që pra të pranishmëve u paraqit me këndimin e ilahisë “Agoi hëna katërmbëdhjetëshe”.

Me këtë rast u mbajt një ligjëratë e shkurtër rreth jetës së njeriut me moralin më të lartë, shembulltyrës së tërë njerëzimit, Muhamedit, s.a.v.s. Këtë ligjëratë tematike e mbajti edukatori, Dr. Muhamed Stublla, duke e shtjelluar atë në mënyrë tejet elokumente.

Nga përmbledhja e vargjeve të mevludit të Tahir efendi Popovës, Kori i Medresesë këndoi disa pjesë, zërat e tyre të bukur, duke e bërë ngjarjen edhe më të mrekullueshme. Dhe, më pas programi vazhdoi me një video të përgatitur enkas për ditëlindjen e të Dërguarit të Allahu, Muhamedit, s.a.v.s., për të përfunduar më pas me ilahinë e kënduar nga Kori i Medresesë “Selam të bëjnë trojet tona, ja Resulallah”.

*Amër Suma 12/2*





## NGA XHAMIA “MIRËSIA” E VUSHTRISË VIJNË VIZITORË TË VEÇANTË NË MEDRESE

Medresenë tonë një ditë e stolisën edhe fëmijët, vizitorët nga xhamia “Mirësia” e Vushtrrisë, të cilët e ndjekin mësim-besimin aty, pranë mësueses së tyre, znj. Makbule Segashi Behrami.

Vizitën e tyre e nisën duke dëgjuar recitimin e Kuranit prej nxënëses sonë Suhejla Franca, e pastaj me një fjalë rasti i nderoi edhe drejtor i shkollës, Mr. Fadil Hasani, i cili u uroi mirëseardhje dhe qëndrim të këndshëm në Medrese.

Për vizitën dhe prezantimin e shkollës deri në detaje u përkujdesën kryetarja dhe nënkryetarja e

KNSh-së, e po ashtu edhe nga djemtë kryetari dhe nënkryetari i KNSh-së.

Vizitorët i shijuan të gjitha ambientet e shkollës, klasat, xhaminë, bibliotekën, sallën e leximit, amfiteatrot, kabinetet e TIK-ut, sallën sportive, restorantin dhe zyrat e administratës, dhe në fund bënë edhe foto të përbashkët.

Urojmë që të kenë kaluar sa më mirë, dhe ta kenë përjetuar sadopak ngrohtësinë që kemi ne këtu në Medrese për çdo ditë!





## AKTIVITETE

Lënda: **Kuran**

Mësimdhënësja: **Prof. Valbona Asllani**

Tema: **"KURANI, UDHËRRËFYES I JETËS SONË"**

Realizuan: **Nxënëset e ShML "Medreseja Alauddin" - Prishtinë**

Vendi: **Amfiteatri i shkollës**

Datë: **12/12/2022**

Moderatore: **Elda Kadriu & Anisa Mehmeti**

Paralelja e vajzave, nën përkujdesjen e profesorshës Valbona Asllani, organizuan një aktivitet mësimor kushtuar Kuranit dhe rëndësisë së tij, me titull: "Kurani, udhërrëfytes i jetës sonë".

Programi ishte i larmishëm, dhe filloi me lexim të një pjese të Kuranit, prej nxënëses Suhejla Franca.

Me një fjalë përshëndetëse dhe mbështetëse për aktivitetet e kësaj natyre të pranishmëve iu drejtua drejtori i shkollës, Mr. Fadil ef. Hasani, i cili i përgëzoi nxënëset për punën dhe angazhimin e tyre.

Po ashtu një fjalë rasti pati edhe profesoresha Valbona Asllani, e cila foli për angazhimin dhe punën e palodhshme të nxënëseve.

Programi vazhdoi me:

- Prezantimin e punimeve të nxënëseve me video-sllajde.

- Tregimin "Mësimi i Kuranit në trevat shqiptare, qysh prej 80 vjetësh dhe sot", të prezantuar prej nxënëses Suhejla Çunaku, i cili prezantim riktheu kuj-

timet e vjetra të vështirësive të gjyshërve tanë, që kishin kaluar gjatë mësimit të Kuranit, dhe që assesi nuk ishin të lehta.

- Interpretimin, nga grupi i vajzave, i ilahisë së thurur pikërisht për këtë program.

- Leximi i sures Asr, prej nxënëses Anisa Banjska, kurse për vlerën dhe komentimin e saj u përkujdes nxënësjë Kanita Rama.

- Monologu "Për ty, Hafize e Kuranit" interpretuar prej Imrane Zariqit.

- Një prezantim i shkurtër i nxënëseve Arnesa Hasani dhe Rumejsa Raçi, rreth vlerës së texhvidit, i cili u përmyll me atë se çka do të thotë ta bartesh Kuranin në zemër.

- Ekspozita e punimeve të ndryshme të nxënëseve të shkollës.

Përmyllja e programit u bë me ndarjen e dhuratave nga Drejtoria e Shkollës, për nxënëset e sapostolisura me mbulesën islame, dhe më pas me një koktej rasti me gjëra ushqimore të përgatitura prej vetë nxënëseve.

Programi i sotëm, në ambientet e shkollës i freskoi zemrat e nxënëseve dhe të të gjithë të pranishmëve, zemrat të cilat ishin të mbushura përplot hare dhe gëzime për sukseset dhe të arriturat e nxënësve, suksese që po i tregojnë gjatë shkollimit të tyre në këtë vatër diturie.





# SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E GJUHËS ARABE NË MEDRESE!

Më 18 dhjetori është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Arabe, prandaj kjo ditë në amfiteatrin e Medresesë u shënua me një program, i cili u shfaq nën përkuqjesjen e mësimdhënësit të gjuhës arabe, profesorit Kujtim Jashanica. Paralelja e vajzave, gjegjësisht maturantet ishin edhe bartëset kryesore të programit, në bashkëpunim edhe me klasat e tjera.

Moderatore ishte Krenare Lipovica dhe Anisa Bytyqi, ndërsa pikat e programit ishin:

- Fillimi me lexim të një ashereje nga Kurani fisnik, prej nxënëses Sarafina Retkoceri.
- Për rëndësinë dhe vlerat e gjuhës arabe foli profesori Shkelzen Hoxha.
- Edhe profesori Kujtim Jashanica e vlerësoi punën e nxënëseve dhe angazhimin e tyre për këtë aktivitet.

- Programi vazhdoi me shfaqjen e video-prezantimeve në arabisht, përgatitur për secilën klasë.

- Për rëndësinë e gjuhës arabe folën edhe nxënëset Sumeja Gashi dhe Kanita Rama.

- Një recital arabisht u interpretua prej nxënpses Emira Hajdini.

- Kuizi në gjuhën arabe u përgatit prej Erina Salihut dhe Tringa Aliut.

- Thënie të disa dijetarëve për gjuhën arabe, të cilat i interpretoi Arnesa Hasani.

- Një fjalë përshëndetëse prej mysafirrit të këtij programi, Prof. Dr. Isa Memishit.

- Fjala përmbyllëse dhe inkurajuese për programe të këtilla prej drejtorit të shkollës, Mr. Fadil Hasanit.



## NË MEDRESE VAZHDOJNË LIGJËRATAT E HAPURA

Në ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë u mbajt ligjëratë e hapur për nxënëset e saj, me të ftuarën, avokaten Rovena Tujani-Klinaku.

Rovena Tujani-Klinaku është avokate, dhe ka kryer master të shkencave juridike. Ajo është koordinatore e gruas pranë Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, si dhe aktiviste e shquar për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Me iniciativë të nxënësve dhe mbështetjen e Drejtorisë, ligjëratat e mbajtur prej avokates Tujani-Klinaku ishte për “Rëndësinë e arsimit universitar”, e cila u përqendrua te forma e organizimit arsimor në Kosovë, domosdoshmëria e studimeve universitare, dhe se cilat janë udhëzimet e nxjerra prej dijetarëve e mendimtarëve të ndryshëm për rrugën e suksesit në karrierën shkencore të çdokujt, duke u fokusuar në këto pika:

- Edukimi gjithëpërfshirës
- Detyrimet qytetare dhe të drejtat
- Korniza ligjore
- Strategjitë e Arsimit

- Fazat e edukimit në ciklin e mesëm
- Matjet akademike
- Vendimet, Nijeti
- Formula e suksesit
- Dilemat e myslimanës

“Vendose Zotin të parin, dhe nuk do të jesh asnjëherë e fundit!”, - ishte këshilla që iu drejtua nxënësve.

Duke pasur parasysh edukimin specifik shkencor dhe fetar që ofron Medreseja, avokatja Tujani-Klinaku, i inkurajoi nxënëset për dije dhe vazhdim të studimeve në fusha të ndryshme, duke i trajtuar mësimet fetare që i ofron Medreseja si vlerë të shtuar në edukimin personal.

Duke pasur parasysh ndikimin pozitiv dhe interaktiv që kishte ligjëratat, avokatja dhe nxënëset e falënderuan drejtorin e Medresesë, Mr. Fadil ef. Hasanin, për mbështetjen, si dhe kërkuan të organizohen edhe ligjëratat të tjera të kësaj natyre.

21/12/2022





## TRAJNIM NGA ORGANIZATA "GREEN ART CENTER"

Tema: "YOUTH IN ACTION ON CLIMATE CHANGE" (RINIA NË VEPRIM PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE)

Trajner: Adhurim Hoxha.

Trajnimi u mbajt në amfiteatrin e ShML "Medreseja Alauddin", e pjesëmarrës ishin anëtarët e EkoKlubit të shkollës, si dhe 24 nxënës të tjerë të përzgjedhur nga klasat e 10-ta dhe të 11-ta.

Në kuadër të projektit përfitues "Ndikimi i Rinisë në Mjedis", në bashkëpunim të organizatave "CARITAS-zviceran", "YENI" dhe "Green Art Center" të cilin EkoKlubi (BShG) të nxënësve të shkollës sonë, pas aplikimit për projekt propozim ishin fitues të tij, dhe ky trajnim u mbajt si lloj "nismë e punëtorive", si dhe u bë e ditur se projekti ka filluar të kalojë në fazën e implementimit.

Përgëzime të shumta për punën e kryer prej nxënësve tanë pati edhe prej vetë trajnerit, i cili tregoi se ishte shumë i kënaqur, dhe se kishte mbetur i mahnitur nga puna e kryer.

Si hyrje e këtij trajnimi ishte prezantimi i kësaj organizate, duke theksuar themelimin për herë të parë, qëllimin si OJQ dhe vizionin, si dhe duke përmendur konceptualisht arsyet kryesore të mbajtjes së trajnimit,

it, e që ishin:

- Rritja e ndërgjegjësimit, aftësive, kapaciteteve, ndërhyrjet për ndryshime klimatike dhe çështje mjedisore;

- Zhvillimi i aftësive komunikuese;
- Identifikimi dhe adresimi, dhe;
- Rritje ndërgjegjësi.

Trajnimi vazhdoi duke përshkruar rezultatet e pritshme të këtij projekti për shkollën tonë. Më pas, me disa këshilla sa i përket aktiviteteve që do të zhvillohen në ambientet e shkollës sonë, sikurse vlerësimi i përvojave aktuale, zhvillimi i aftësive edhe të nxënësve të tjerë, që pritet të jenë anëtarë të eko klubeve, apo edhe nismëtarë në fushat e mbrojtjes së mjedisit, duke qenë edhe nxënësit tanë pjesë e tyre, u propozua shtimi i aktiviteteve në të ardhmen, si dhe të zhvillohen kampanja të ngjashme.

Tema të trajtuara gjatë trajnimit ishin edhe karboni, ndikimi i tij në ndotjen e mjedisit, masat që mund të merren, si dhe shkaktarët e ndryshëm të ndryshimeve klimatike, e që nxënësit patën rastin t'i shprehin edhe mendimet/opinionet e tyre.

E, si përfundim ishte porosi e kontributit të vazhdueshëm për mjedisin, se: "KEMI BORXH NJË MJEDIS TË PASTËR"





MË 08.03.2023

## NË AMBIENTET E KONVIKTIT TË VAJZAVE U MBAJT LIGJËRATA E RADHËS PREJ GYLTENE DËRGUTIT, MAGJISTRE E PSIKOLOGJISË KLINIKE

TEMA: "RËNDËSIA E SHËNDETIT MENDOR NË ADOLESHENCË"



Duke qenë se adoleshenca është një periudhë e zhvillimit, kur kalohet nga fëmijëria drejt një personi të rritur, gjatë kësaj periudhe, krahas zhvillimit fizik, njeriu përjetohen edhe ndryshime kognitive, emocionale dhe sociale. Këto ndryshime ndonjëherë adoleshentin e sjellin para sfidave vështirë të përballueshme. Jo të gjithë adoleshentët e përjetojnë njëjtë, dhe kjo gjë ndikohet nga fak-

torët e ekosistemit të tij apo të saj. Ata që kanë vështirësi në formimin e identitetit të tyre, sigurisht se kanë predispozitë të zhvillojnë edhe probleme apo çrregullime të shëndetit mendor. Ë rëndësishme këtu është që ata adoleshentë që përballen me këto vështirësi, sapo ta ndiejnë nevojën, të kërkojnë ndihmë profesionale psikologjike, krahas konsultimeve që mund t'i bëjnë me familjarët apo personelin arsimor.



## ME RASTIN E FESTAVE TË NËNTORIT: TURNIRI I VAJZAVE NË VOLEJBOLL

Gjatë kësaj jave, për hir të Ditës së Flamurit, u zhvillua turniri në volejboll, për t'u përmbyllur me finalën e zhvilluar ndërmjet ekipit të klasës së 10/4 dhe 12/3, në të cilën garë fituese doli ekipi i klasës së 10/4.

Pjesëmarrës ishin secila nga gjashtë paralelet e vajzave të ShML "Medreseja Alauddin"- Prishtinë, të cilat morën pjesë me nga një ekip.

Renditja e ekipeve nga 1 deri në 3 ishte si në vijim:  
1) 10/4; 2) 12/3 dhe 3) 12/4.

Ekipin fitues, klasën e 10/4, e urojmë përzemërsisht, si dhe i dëshirojmë suksese të mëtutjeshme, kurse ekipet e tjera i falënderojmë për pjesëmarrje, si dhe i urojmë për konkurrencën e denjë!



10/4 - PRISHTINË



## MENAXHIMI I KOHËS

E hënë, më 13 mars 2023, u mbajt aktiviteti i radhës, në të cilin u prezantua një ligjëratë e dobishme nga ana e dy nxëneseve të klasës së 10/4, Xhezide Osmani dhe Esra Bytyqi.

Në fillim u lexua kaptina El Asr (Koha), meqë edhe kishte lidhje të drejtpërdrejtë me temën.

Pastaj dy nxënëset i paraqitën pikat kryesore të temës që do ta zhvillonin, e që ishin:

- Natyra e kohës
- Koncepti i menaxhimit të kohës
- Përfituesit dhe humbësit e kohës
- Menaxhimi i kohës në Islam

Më tutje ato folën për secilën nga ato pika, si dhe për çështje të tjera, siç janë:

- Karakteristikat e kohës
- Disa fjalë rreth komentimit të kaptinës kuranore “El Asr – Koha”

- Pengesat e shfrytëzimit optimal të kohës
- Boshti I menaxhimit
- Piramidat e objektivave dhe ndarja e tyre
- Si e menaxhon bota kohën, dhe si i menaxhon detyrat?

Edhe në këtë aktivitet nuk mungoi prezenca e kujdestares, profesorehave dhe mbështetja e pakursyer menaxhmentit të shkollës.

Para se të ndaheshin, pjesëmarrëset e shpërndanë edhe nga një pyetësor të shkurtër, si mundësi e mirë për secilën pjesëmarrëse, që ta jap vlerësimin në lidhje me ligjëratën dhe mënyrën e menaxhimit të kohës.

Si përfundim, për nxënëset urojmë suksese të më-tutjeshme, dhe që ligjëratat të tilla përplot dobi të jenë edhe më të shpeshta në amfiteatrin e Medresesë! Amin!



06.04.2023

## TEMA: "BULLIZMI DHE MASAT PARANDALUESE"

LIGJËRUESE: RRESHTERE - FIDANE BALLAZHI

ASISTENTJA/SHOQËRUESJA: XHEMILE BEHLULI

Në ambientet e amfiteatrit të ShML "Medreseja Alauddin" u mbajt ligjërata për çështjen e bullizmit, sikurse u mbajt edhe disa ditë më parë, mirëpo kësaj here pjesëmarrëse ishin nxënëset e shkollës. Ligjëratat trajtoi pika të ndryshme, duke filluar nga vetë koncepti i bullizmit, e deri te masat parandaluese.

Kjo temë zgjoi interesim të madh te nxënëset, falë dy ligjërueseve të cilat arritën realizimin e një ligjërate tërheqëse për veshët e pjesëmarrësve, duke fituar vëmendjen e tyre të plotë. Në asnjë rast nuk mungoi gatishmëria e ligjërueseve në pyetjet e ndryshme të

nxëneseve, e të cilat vetëm se i mirëprisnin ligjërueset nga policia e Kosovës.

Si përfundim ato përçuan mesazh të rëndësishëm të sigurisë dhe të gatishmërisë për çdo gjë në favor të njerëzve, e sigurisht përfshirë edhe sigurinë tonë.

Ne e falënderojmë përzemërsisht Policinë e Kosovës, gjegjësisht major Ramadan AHMETIN, shef i Sektorit për Parandalim të Krimit, për bashkëpunimin, dhe në veçanti i falënderojmë dy edhe ligjërueset për prezantimin e tyre të shkëlqyeshëm dhe kohën e ndarë!





## IFTAR PËR TË GJITHA NXËNËSET NË AMBIENTET E SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN"

Më datë 07.04.2023, e premte, në restorantin e ShML "Medreseja Alauddin", nga Drejtoria e shkollës është organizuar iftar për të gjitha nxënëset (konviktore dhe jokonviktore). Në iftar morën pjesë profesoret, përgjegjësjat e konviktit dhe edukatorët.

Pas përfundimit të iftarit dhe faljes së namazit të akshamit, u mbajt edhe një program i shkurtër relaksimi për pjesëmarrëset.


Programi u hap me lexim të Kuranit famëlartë, gjegjësisht të ajeteve të agjërimit, që i lexoi nxënësjat

Anisa Dibrani.

Pastaj të pranishmeve iu drejtua me një fjalë rasti edhe kryetarja e shkollës, paraleleve të vajzave, Fjolla Miftari. Ajo uroi që në Medrese të ketë edhe shumë iftare të bereqetshme, sikurse ky i kësaj mbrëmjeje.

Programi vazhdoi me këndimin e dy ilahive, paraqitur nga kori i vajzave, si dhe prezantimin e disa slajdeve të përgatitura prej nxënëseve.

Në fund programin e përmbylli Kanita Rama, me leximin e tre ajeteve të fundit të kaptinës El Bekare.





## PROGRAMI PËR MATURANTE

Më datë 10.05.2023, e mërkurë, në ambientet e ShML "Medresesë Alauddin" në Prishtinë, në paralelen e vajzave u mbajt një program modest dhe lamtumirës për maturantet.

Ky program u përgatit nga klasat e 11-ta dhe të 10-ta, e moderimin e bënë nxënëset: Eljesa Maxhuni, 11/4 dhe Anisa Banjska, 11/5.

Programi filloi me lexim të ajeteve të para të sures Err Rrahman, prej nxënëses Saime Hoti, për të vazhduar më tej me një fjalë rasti të drejtorit, Fadil Hasani, dhe kujdestarët e klasave të 12/3 dhe 12/4, profesresha Shahë Memishi dhe profesori Rrahim Aliu.

Për t'ia shtuar këtij programi hijeshinë, doli edhe kori i vajzave me ilahi, e pastaj nxënëset Kanita Hyseni dhe Dua Çmega me një poezi. Më tej programi vazhdoi edhe me disa sekuenca të shkurtra fotosh,

bashkangjitur me një kuiz, krejt këto të përgatitura prej nxënëses Rrezana Kelmendi.

Në skenë nuk mungoi as interpretimi i esesë kushtuar medresesë, të cilën e interpretoi nxënësjja Elmedina Ibrahim. Programi vijoi më tej me nxënëset Lumnie Sadiku dhe Suhejla Krasniqi, me poezitë e tyre, e pas tyre u shfaq edhe një video kujtimesh për tre vjet në Medrese, përgatitur prej nxënëses Arjeta Grajçevci.

Fjalimet e kryetares Fjolla Miftari dhe nënkryetares Imrane Zariqi, ishin pjesë e programit në vazhdim, të cilat i falënderuan nxënëset për programin e përgatitur.

E, për t'i dhënë fund programit, u bë edhe shpërndarja e dhuratave, të cilat me shumë emocion vajzat i kishin përgatitur për maturantet!





## INAUGURIMI I PROJEKTIT MJEDISOR NGA EKOKLUBI I SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PRISHTINË

Inaugurimi i projektit mjedisor nga EkoKlubi i ShML "Medreseja Alauddin" në Prishtinë, u realizua në kuadër të CaCH "Youth Environmental Impact" (YENI), përmes GAC projektit "Youth in Action on Climate Change".

Më datë 12.05.2023, në ambientet e amfiteatrit të ShML "Medreseja Alauddin" u mbajt ceremonia e inaugurimit të projektit EkoKlubor "Vetëdijësimi dhe bashkëpunimi i nxënësve, duke i kontribuar mjedisit", në prezencë të stafit të shkollës dhe të organeve të rëndësishme të përfaqësuesve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, CaCH dhe OJQ-së Green Art Center Prishtina.

Ceremoninë e hapi moderatorja Erina Salihu, me një fjalë rasti e duke i përshëndetur dhe falënderuar gjithë të pranishmit për pjesëmarrje, dhe njëkohësisht duke e falënderuar edhe drejtorin e shkollës, z. Fadil ef. Hasani, që gjithmonë shprehu gatishmëri për çdo gjë gjatë hartimit, projektimit dhe zbatimit të



këtij projekti.

Më pas edhe drejtori u ftua në skenë për një fjalë rasti, ndërsa pasi pati rastin t'i falënderojë gjithë të pranishmit në këtë ditë të veçantë, lëvdata të shumta dha edhe për vetë arsyen e kësaj ceremonie, anëtarët e EkoKlubit të shkollës, për punën e palodhshme dhe përkushtimin e tyre gjatë gjithë kohës.

Më pas fjala i kaloi përfaqësueses së organizatës donatore zvicerane CARITAS, znj. Fjollë Cakaj, e cila

shprehu kënaqësinë e përjetuar nga puna e nxënësve, duke përmendur edhe përvojat e saj me shkollat e tjera, dhe si përfundim duke i uruar grupit aktivist EkoKlubor suksese te mëturjeshme. Pas fjalimit të znj. Fjolla, duke e falënderuar për fjalimin dhe fjalët e bukura, në skenë u ftua përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, z. Shani Hamitaga, i cili në fjalimin të tij shprehu mirënjohje ndaj stafit të shkollës, për mikpritjen, si dhe lëvdata të veçanta edhe për EkoKlubin (BShG), njëkohësisht në pika të shkurtra, duke treguar rrugëtimin e nxënësve në shkollat e ndryshme të Prishtinës, dhe duke e përmbyllur me urimin për çdo të mirë për EkoKlubin dhe të rinjtë.

Z. Adhurim Hoxha, përfaqësues/menaxher dhe trajner i OJQ-së "Green Art Center Prishtina", meriton çdo lëvdatë për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe gatishmërinë e tij gjatë gjithë përpunimit të projektit.

Me përfundimin e fjalimeve, moderatorja dhe njëkohësisht edhe përfaqësuesja e EkoKlubit, Erina Salihu, bëri prezantimin e projektit në fjalë, duke treguar problematikat, nismën, objektivat kryesore, dhe duke prezantuar edhe rezultatet e mira përmes slajdeve.

EkoKlubi "Better Shades of Green" i Medresesë janë fitues të projektit, i cili u inaugurua sot, e i cili kap vlerën 4840 €. Në bazë të këtij buxheti ata arritën të përfshijnë shumë gjëra/produkte në kuadër të shkollës, dhe njëkohësisht duke i kontribuar edhe mjedisit.

Objektivat ishin:

-Vetëdijësimi i nxënësve të shkollës dhe kujdesi i madh i nxënësve në raportet e tyre me mjedisin.

-Kursimi i ujit dhe i energjisë elektrike, përmes marrjes së masave, e që do të jenë në favor të nxënësit dhe të mjedisit.

-Rritja dhe shfrytëzimi i hapësirave të gjelbra prej nxënësve të shkollës, duke përfshirë edhe përkudjesjen ndaj tyre.

Rezultatet e projektit janë:



-Kursimi i ujit përmes instalimit të 16-të rubine-  
teve me sensor në hapësirat e brendshme të shkollës.

-Kursimi i energjisë elektrike përmes instalimit të  
6-të trupave ndriçues LED në hapësirat e jashtme të shkollës.

-Rritja e hapësirave të gjelbra brenda shkollës,  
përmes mbjelljes së 90 bimëve (luleve) shumëvjeçare.

- 395 nxënës të shkollës "Medreseja Alauddin"  
kanë qasje në kopshtin e shkollës përmes vendosjes  
së 10 pushimoreve, duke pasur mundësi rekreacioni  
dhe ekspozim ndaj ajrit të pastër.

Prezantimi u përmbyllur me një video të përgati-  
tur prej anëtarit të Eko Klubit, Burhan Avdullahut,  
mbi rubinetët e instaluar sensorikë.

Kjo ditë u përmbyll me zbulimin e pllakatit përgë-  
zuese, vënë në emër të shkollës, dhe nxënësit u  
përgëzuan me mirënjohje në emër të dy organizat-  
ave dhe MZHR-së.

Shpresojmë që arritje të tilla të kemi gjithmonë, e  
nxënësit tanë të vazhdojnë të na bëjnë krenarë me  
sukseset e tyre!





## GARA NDËRKOMBËTARE “SELAM PËR TY”

Të enjten, më 11.05.2023, në ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë, në Prizren dhe në Gjiilan, njëkohësisht u zhvilluan gara ndërkombëtare “SELAM PËR TY”, që për qëllim ka përshëndetjen “Selam për TY, o Muhamed, a.s.!”.

Gara “SELAM PËR TY” është ideuar si konceptim i njohjes dhe mësimi sa më mirë të biografisë së Muhamedit, a.s., prej sa më shumë nxënësve të medreseve, dhe atë në gjuhët e tyre amëtare.

Në këtë garë pjesëmarrëse ishin medresetë – Imam Hatib nga Turqia, medresetë nga Ballkani: nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore, me pyetjet në gjuhën shqipe të përgatitura nga Komisioni i themeluar nga “Medreseja Alauddin” e Prishtinës. Bazë për përpilimin e pyetjeve ishte libri “Muhamedi a.s., Profeti Islam” i autorit Imam Vehbi Ismaili.

Në këtë garë pjesëmarrës ishin edhe medresetë nga Bullgaria, Bosnia dhe Hercegovina, si dhe nga

Sanxhaku, me pyetjet e përgatitura në gjuhët e tyre përkatëse dhe librat përkatës mbi jetën e Muhamedit, a.s.

Kjo garë, në ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë, në Prizren dhe në Gjiilan u organizua nga Bashkësia Islame dhe Zyra e Dijanetit në Prishtinë.

Tre vendet e para në Prishtinë, tre vendet e para në Prizren dhe tre vendet e para në Gjiilan për shpërbllim do ta gëzojnë shkuarjen në UMRE, në pushimin dimëror të vitit shkollor 2023/2024.

Në ceromoninë solemne të hapjes së garës “SELAM PËR TY”, e cila u mbajt në amfiteatrin e ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë, përveç nxënësve, mësimsdhënësve dhe edukatorëve, mori pjesë edhe kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Vedat ef. Sahiti, si dhe Konsulenti i Zyrës së Dijanetit të Turqisë në Prishtinë, z. Bunjamin Albajrak.

Me këtë rast i urojmë fituesit, po edhe të gjithë pjesëmarrësit!





## VIZITA E MATURANTËVE TË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" NË FAKULTETIN E STUDIMEVE ISLAME NË PRISHTINË

Më 21/03/2023 Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës u vizitua prej maturantëve të ShML "Medreseja Alauddin" të Prishtinës. Maturantët ishin të shoqëruara prej profesorëve kujdestarë: Adnan Simnica dhe Kujtim Jashanica.

Edhe maturantët, sikurse maturantet një ditë më parë, u pritën prej dekanit të Fakultetit, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani me bashkëpunëtorë.

Dekani Hasani fillimisht u shprehu mirëseardhje në ambientet e Fakultetit, dhe në vazhdim të pranishmit i informoi me historikun e Fakultetit, programet që ofron FSI-ja, stafin akademik, kushtet dhe infrastrukturën që e ofron ky fakultet për studentët që i vazhdojnë studimet në këtë institucion të arsimit të lartë islam në vendin tonë.



## LIGJËRATAT JASHTËKURRIKULARE

Ligjërues të disa ligjëratave jashtëkurrikulare të zhvilluara në Medrese ishin: Profesori i lëndës së Fikhut, Ekrem Maqedonci dhe profesori i lëndës së Akaidit, Muharrem Tërnavë.

Më datë 01.03.23, në Medrese u mbajt një ligjëratë, si aktivitet jashtëkurrikular, e cila u zhvillua prej profesorit të Fikhut, Ekrem Maqedoncit, ndërsa kishte temën "Ebu Hanifeja". Në ligjëratë ishte të pranishëm edhe drejtori i shkollës, prof. Fadil Hasani, i cili i përshëndeti profesorin dhe nxënësit,

dhe i inkurajoi ata për mësim dhe avancim të vazhdueshëm në kërkimin e diturisë.

Më datën 18.01.23 u mbajtë ligjëratë me temën "Besimi i drejtë", e cila u zhvillua prej profesorit të Akaidit, Muharrem Tërnavës. Nxënësit u ndanë shumë të kënaqur me aktivitetin e profesorëve, ngase ishte një mundësi e shkëlqyeshme për t'i dëgjuar dhe për të diskutuar për ato çështje që, ndoshta, nuk ka hapësirë për të diskutuar në orët mësimore.

*Almir Isaku 12/2*





## KËSHITU U FESTUA “28 NËNTORI” NË SHML “MEDRESEJA ALAUDDIN”

Si çdo festë, në amfiteatrin e Medresesë Alauddin u organizua program edhe me rastin e festës së “28 Nëntorit”.

Programi filloi me një pjesë të përzgjedhur nga Kurani fisnik. E menjëherë pas saj u bë intonimi i himnit të flamurit, ndërsa më pas kryetari dhe kryetarja e shkollës programin e vazhduan me nga një fjalë rasti, për nder të kësaj dite, fillimisht duke i përshëndetur gjithë të pranishmit dhe duke ua uruar festën, e pastaj edhe disa fjalë të përzgjedhura dedikim kësaj dite të bashkimit.

Më pas u ftua në skenë profesor Jakup ef. Çunaku, për një fjalë rasti, i cili i uroi të pranishmit për festën e “28 Nëntorit” në emër të drejtorit të shkollës, z. Fadil ef. Hasani.

Profesori Çunaku përmbledhi qëllimin e kremtimit të 28 Nëntorit, duke shtuar disa fjalë rreth përjetimeve dhe vështirësive të shqiptarëve përgjatë kohës deri në cakun e çlirimit, duke e kërkuar çelësin e lirisë.

Falënderime të veçanta iu dedikuan drejtorit tonë, edhe pse nuk ishte i pranishëm, i cili na nxiti gjithmonë drejt suksesit dhe është mbështetësi e përkrahësi më i madh në çdo hap që hedhim.

Në vijim në skenë u ftua z. Fatmir ef. Iljazi, i cili pas urimit tha edhe disa fjalë dedikuar kësaj feste. Ai

pati rastin edhe t'i këshillonte nxënësit e ShML “Medreseja Alauddin”, duke treguar përvojën e tij si medresist.

Më pastaj programi vijoi me korin e djemve, që performoi dy ilahi, të titulluara: “ADEM JASHARI” dhe “JAM SHQIPTAR DHE MUSLIMAN”.

Pas ilahive u recituan vargjet:

“O shqiptar që aq shumë vuajtje,  
Në emër t’Zotit pot baj një lutje  
Nëse ndodhësh dikundë gjallë  
Thuaja nanës bir veç një fjalë.”

E me këtë rast, pas vargjeve të shkëputura nga recitali fragmentar, në skenë u paraqit kori i vajzave, për ta interpretuar një poezi të përcjellë me ndjenja dhe emocione të veçanta para publikut.

Për ta begatuar rrjedhën e programit para pjesëmarrësve u shfaqën sekuenca të shkëputura nga filmi: “Nëntori i dytë”.

Me përfundimin e pjesëve të shkëputura të filmit, ndjenja të papërshtueshme emocioni, që arriti t'i prekte zemrat e gjithë publikut dha edhe interpretimi i nxënësit Ron Bajoku, nga klasa 10/2, me monologun e titulluar: “PO IKI NËNË”.

Krejt në fund programi u përmbyll me melodi të bukur nga zëri i korit të vajzave, me ilahinë: “TI SHQIPËRI MË JEP NDER”.



## NË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" U MBAJTËN GARAT E DITURISË (27-28 PRILL 2023)

ShML "Medreseja Alauddin" në Prishtinë i organizoi dhe i mbajti GARAT E DITURISË, më 27 dhe 28 prill të këtij vitit, gara këto që u mbajtën në nivel shkollë: Shkolla Amë, në Prishtinë, Paralelja e Prizrenit dhe Paralelja e Gjilanit.

Në këto gara pjesëmarrës ishin nxënësit/et nga 26 paralele, me ekipet e tyre të përbëra prej tre nxënësve/eve, me gjithsej 78 garues.

Gara u zhvillua në dy kategori:

A) E meshkujve, dhe;

B) E femrave.

Gjithashtu, secili nivel garoi veç e veç:

1. Klasa e 10-të, 4 paralele (ekipe) të djemve dhe 5 paralele (ekipe) të femrave;

2. Klasa e 11-të, 5 paralele (ekipe) të djemve dhe 4 paralele (ekipe) të femrave;

3. Klasa e 12-të, 4 paralele (ekipe) të djemve dhe 4 paralele (ekipe) të femrave;

Garat u zhvilluan nga njësitë e plan-programit mësimor, në këto lëndë mësimore, varësisht nga niveli i garës:

- Gjuhë shqipe
- Gjuhë arabe
- Gjuhë angleze
- Fizikë
- Kimi
- Matematikë
- TIK
- Biologji
- Akaid
- Fikh
- Histori
- Shkencat e Kuranit
- Komentimi i Kuranit
- Shkencat e Hadithit
- Hadith
- Psikologji
- Sociologji

Garat u realizuan përmes platformës KAHOOT, dhe për secilin nivel u shtruan nga 55 pyetje.

ShML "Medreseja Alauddin" për herë të parë zhvilloi një garë kaq të madhe në platformën KAHOOT, duke shfrytëzuar Teknologjinë Informativë në Arsim, gjë që si formë kurseu kohën, dha vlerësimin e saktë dhe të shpejt, si dhe krijoi një atmosferë relaksuese të garuesit dhe stafi udhëheqës dhe ai arsimor e edukativ.

Garat ishin mjaft konkurruese, dhe shpresojmë të jenë të dobishme për nxënësit!

Rezultatet e garave:

KLASA E 12-të:

1) KATEGORIA E VAJZAVE

- VENDI I PARË, 12/3 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 12/8 -Gjilan
- VENDI I TRETË, 12/4 -Prishtinë

2) KATEGORIA E DJEMVE

- VENDI I PARË, 12/1 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 12/2 -Prishtinë
- VENDI I TRETË, 12/7 -Gjilan

KLASA E 11-të:

1) KATEGORIA E VAJZAVE

- VENDI I PARË, 11/4 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 11/5 -Prishtinë
- VENDI I TRETË, 11/9 -Gjilan

2) KATEGORIA E DJEMVE

- VENDI I PARË, 11/3 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 11/6 -Prizren
- VENDI I TRETË, 11/1 -Prishtinë

KLASA E 10-të:

1) KATEGORIA E VAJZAVE

- VENDI I PARË, 10/4 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 10/3 -Prishtinë
- VENDI I TRETË, 10/9 -Gjilan

2) KATEGORIA E DJEMVE

- VENDI I PARË, 10/2 -Prishtinë
- VENDI I DYTË, 10/1 - Prishtinë
- VENDI I TRETË, 10/5 - Prizren

Drejtorja e shkollës, në konsultim me Komisionin për organizimin e garës, u kujdes që të ndajë certifikata-mirënjohje për garuesit/et, si dhe ndau çmime për fituesit/et e garave në secilën kategori, në të tre nivele.

Me këtë rast i urojmë fituesit, si dhe i falënderojmë të gjithë garuesit për angazhimin e tyre!

Po ashtu e falënderojmë Komisionin Organizativ të Garës, profesorët, edukatorët dhe punëtorët teknik, pra, të gjithë ata që u kujdesën për mbarëvajtjen e garës!







12/3 - PRISHTINË



12/1 - PRISHTINË



11/4 - PRISHTINË



11/3 - PRISHTINË



10/4 - PRISHTINË



10/2 - PRISHTINË





## DUAJA E HATMES E GJENERATËS SË 56-TË TË MATURANTËVE TË MEDRESESË

Dikur moti Medreseja Alauddin në Prishtinë kishte kapacitet për pesë klasë mësimi, me gjithsej 150-180 nxënës përafërsisht (meshkuj që të gjithë), e të cilët vinin nga disa vende të rajonit, kurse vitin e kaluar nga ShML "Medreseja Alauddin" në tërësi diplomuan 234 nxënës/e.

Këtë vit shkollor Medreseja ka 220 maturantë gjithsej, e të cilët së shpejti edhe do të diplomojnë.

Tanimë është bërë traditë që përmbyllja e shkollimit në Medrese të bëhet edhe me ceremoninë e "DUASË SË HATMES", në një mënyrë procedurale festive.

Sot kjo ceremoni u mbajt prej 60 maturantëve të Prishtinës, në prani të familjarëve të tyre, të myftiut të Bashkësisë Islame të RKS-së, Mr. Naim ef. Tërnavës me bashkëpunëtorë, të mësimdhënësve dhe të edukatorëve të Medresesë.

Në një atmosferë imponante dhe më se emocionale për të gjithë, maturantët u paraqitën në skenë duke kënduar tekbirot, në shenjë gëzimi për suksesin e arritur, dhe për t'i përshëndetur të pranishmit dhe për t'u dëshiruar mirëseardhje u kujdesën kryetari dhe nënkryetari i KNSH-së, Shpat Krasniqi dhe Amër Suma.

Më pas drejtori i shkollës, Mr. Fadil Hasani, në fjalën e tij të rastit për këtë ngjarje, i përshëndeti të pranishmit, ndërsa maturantëve u uroi për arritjen, ndërsa myftiun e falënderoi për mbështetjen, e kujdestarët dhe stafin arsimor-edukativ për punën dhe angazhimin e tyre. Po ashtu, me këtë i uroi dhe i falënderoi edhe familjarët, për bashkëpunimin dhe besimin që kanë pasur vazhdimisht ndaj Medresesë.

Me fjalë mjaft të zgjedhura dhe inkurajuese, por edhe mbështetëse për ta çmuar vlerën e Medresesë, mësimëve të saj, punës së menaxhmentit dhe stafit të shkollës, u përkujdes edhe myftiu i nderuar, Mr. Naim Tërnavë, i cili i uroi nxënësit për suksesin e arritur, stafin e Medresesë për punën dhe angazhimin, kurse prindërit për besimin e tyre ndaj Medresesë, në veçanti, e edhe ndaj Bashkësisë Islame, në përgjithësi. Ai, përveç tjerash, tha: "Vlerën e Medresesë në edukimin dhe arsimimin e shumë gjeneratave nuk mund ta përshkruajë fjala, e as ta shkruajë lapsi...".

Në fund të pjesës hyrëse fjala iu kalua edhe profesorit të Kuranit të kësaj gjenerate, Mr. Jakup Çunakut, i cili evokoi kujtime dhe peripeci që e përcollën

këtë gjeneratë, e cila e filloi shkollimin në Medrese në kushte pandemie, mirëpo arriti suksese të theksuara. Ai e lavdëroi mbështetjen e Bashkësisë Islame dhe të Drejtorisë së shkollës, ndërsa nxënësve ua shprehu urimet më të mira.

Në emër të prindërve të kësaj gjenerate të maturantëve, të pranishmëve iu drejtua përfaqësuesja e Këshillit të Prindërve të kësaj gjenerate, znj. Gyltene Dërguti, e cila uroi maturantët për suksesin e tyre. Ajo, më pastaj tha fjalët më të bukura për Medresenë, e cila vazhdon të jetë shkollë elitare me punën e saj, duke kujtuar edhe gjeneratat e mëhershme që dolën nga kjo shkollë e bekuar. Ajo falënderoi Drejtorinë e shkollës, stafin dhe të gjithë ata që u kujdesën për suksesin dhe edukimin e nxënësve.

Pas leximit të disa pjesëve të caktuara të Kuranit famëlartë nga secili maturant, u bë Duaja e Hatmes.

Ceremonia e DUASË SË HATMES u përmbyll duke shpallur nxënësit e dalluar në nivel të klasave të djemve, si dhe nxënësin e dalluar në nivel të të gjitha paraleleve të djemve, e pastaj përfaqësuesve të EKO KLUBIT të shkollës dhe përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm.

Nxënësve të dalluar iu ndanë mirënjohje dhe shpërblime modeste nga Drejtoria e shkollës, si dhe prej myftiut, z. Naim Tërnavë.

Urimet më të mira për nxënësit e kësaj gjenerate, e vetëm sukseset në rrugëtimin e tyre edhe në të ardhmen qofshin pjesë e jetës!

Mirënjohje për nxënës të dalluar morën:

1. Amër Suma, kl. 12/2 – NXËNËS I DALLUAR NË NIVEL SHKOLLE

Në NIVEL KLASE u dalluan:

2. Shpëtim Smajli, kl. 10/1,
3. Ron Bajoku, kl. 10/2,
4. Art Salihu, kl. 11/1,
5. Enes Ganiu, kl. 11/2,
6. Shuajb Ramadani, kl. 11/3,
7. Shuajb Bytyqi, kl. 12/1, dhe
8. Albion Kamberi, kl. 12/2.

Mirënjohje dhe shpërblime iu ndanë edhe grupit të EKO KLUBIT:

9. Burhan Abdullahu, kl. 12/1,
  10. Enmar Islami, kl. 12/2, dhe
  11. Mexhid Tërnavë, kl. 12/2.
- Kryetarit të KNSH:
12. Shpat Krasniqi, kl. 12/2.





1. Amër Suma



2. Shpëtim Smajli



3. Ron Bajoku



4. Art Salihu



5. Enes Ganiu



6. Shuajb Ramadani



7. Shuajb Bytyqi



8. Albion Kamberi



9. Burhan Abdullahu



10. Enmar Islami



11. Mexhid Tërnavë



12. Shpat Krasniqi

## GJENERATA E 22-TË E MATURANTEVE TË MEDRESESË E BËNË DUANË E HATMES

Tradita vazhdon, dhe rezultatet nuk mungojnë. Tani ato na i sjell gjenerata e 22-të e vajzave të ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë.

Sot 69 maturante të Medresesë Alauddin në Prishtinë e bënë ceremoninë e Duasë së Hatmes, shfaqur në prani të familjarëve të tyre, të kryeimamit të Bashkësisë Islame të RKS-së, z. Vedat ef. Sahiti me bashkëpunëtorë, të stafit mësimdhënës dhe të edukatoreve të Medresesë.

Në një atmosferë mrekullueshme maturantet u prezantuan në amfiteatrin e shkollës, duke kënduar tekbiere dhe duke shprehur gëzimin e tyre për suksesin e arritur.

Fillimisht maturantja Sarafina Ratkoceri e këndoi një pjesë nga Kurani i madhëruar, e pastaj të pranishmit u përshëndetën me urimet për mirëseardhje nxënëset, e që e shprehën nxënëset Fjolla Uka dhe Anisa Dibrani.

Drejtori i shkollës, Mr. Fadil Hasani, edhe në këtë rast, në fjalën e tij, i përshëndeti të pranishmit, i uroi prindërit dhe mësimdhënësit, e në veçanti maturantet, për angazhimin dhe arritjet e tyre, duke shprehur konsideratën e thellë ndaj kësaj gjenerate të shkëlqyer të medresistëve.

Të pranishmëve, në emër të myftiut, Naim ef. Tërnava, iu drejtua me një fjalë rasti kryeimami i BI-së të Kosovës, z. Vedat ef. Sahiti, i cili i uroi nxënëset për suksesin e arritur, udhëheqjen e shkollës dhe stafin për punën dhe angazhimin, kurse prindërit për besimin e tyre ndaj Medresesë, në veçanti, e edhe ndaj Bashkësisë Islame, në përgjithësi.

Në fund të pjesës hyrëse fjala iu kalua edhe mësimdhënëses së lëndës së Kuranit të kësaj gjenerate, Mr. Valbona Asllani, e cila shprehu fjalët më të mira për këtë gjeneratë të shkëlqyer, të cilat e mësuuan Kurantin me shumë vullnet.

Në emër të prindërve të kësaj gjenerate të maturanteve, hoxhë Enis ef. Rama, kryetar i KBI-së të Mitrovicës iu drejtua të pranishmëve, duke i uruar maturantet për suksesin e tyre, e pastaj ndau fjalët më të zgjedhura për punën dhe rolin e Medresesë Alauddin, tempullit të dijes dhe të edukimit të

mirëfilltë të shumë gjeneratave. Ai e falënderoi Drejtorinë, stafin dhe të gjithë ata që u kujdesën për suksesin dhe mirëqenien e nxënëseve.

Pas të leximit të disa pjesëve të Kuranit prej secilës nxënëse maturante, Duanë e Hatmes e bënë nxënëset: Suhejla Franca dhe Kanita Rama.

Ceremonia e DUASË SË HATMES u përmbyll duke i shpallur nxënëset e dalluara në nivel të klaseve të paraleles së vajzave, si dhe nxënësen e dalluar në nivel shkolle, e pastaj përfaqësueseve të EKO KLUBIT të shkollës dhe përfaqësueseve të sektorëve të ndryshëm.

Nxënëset e dalluara morën mirënjohje dhe shpërblime modeste nga Drejtoria e shkollës, si dhe prej myftiut, z. Naim ef. Tërnava.

Drejtoria e shkollës shpreh urimet më të mira për maturantet e kësaj gjenerate të dalluar!

Qoftë i kënaqur Zoti ynë me nxënëset e Medresesë dhe punonjësit e saj!

Mirënjohje dhe shpërblime për nxënëse të dalluara morën:

**NXËNËSEJA MË E DALLUAR NË NIVEL SHKOLLE:**

1. Fjolla Miftari, kl. 12/3 – Në NIVEL KLASE u dalluan:
2. Haxhere Idrizi, kl. 10/3,
3. Ruvejda Bejtullahi, kl. 10/4,
4. Dua Çmega, kl. 11/4,
5. Medina Bajgora, kl. 11/5,
6. Zejneb Amatullah Vrapca, kl. 12/3, dhe
7. Erina Salihu, kl. 12/4.

Mirënjohje dhe shpërblime iu ndanë edhe përfaqësueseve të EKO KLUBIT:

- 7a. Erina Salihu, kl. 12/4,
8. Ermira Ramabaja, kl. 12/4, dhe
9. Krenare Lipovica, kl. 12/3.

Mirënjohje dhe shpërblime u ndanë edhe për:

10. Rumeja Raçi, kl. 12/3 për angazhim në GRUPIN PËR INFORMIM, si dhe;

11. Sara Gashi, kl. 12/4 përfaqësuese e sektorit të sportit.





1. Fjolla Miftari



2. Haxhere Idrizi



3. Ruvejda Bejtullahi



4. Dua Çmega



5. Medina Bajgora



6. Zejneb Amatullah Vrapça



7. Erina Salihu



7a. Erina Salihu



8. Ermira Ramabaja



9. Krenare Lipovica



10. Rumejsa Raçi



11. Sara Gashi



02.06.2023

## MBRËMJA E MATURËS SË GJENERATËS SË 56-TË TË DJEMVE

Maturantët e Medresesë mbrëmë kishin natën e maturës, që si tradicionalisht u mbajt në ambientet e shkollës.

Kjo ishte një mbrëmje sa e hareshme për maturantët, po aq edhe emocionuese. E hareshme sepse maturantët e mbaruan shkollimin e mesëm të lartë në Medrese, ku u arsimuan, u edukuan dhe u formuan me mësimet më të veçanta që di t'i japë vetëm Medreseja Alauddin, kurse në anën tjetër, kjo mbrëmje ishte emocionuese sepse ishte nata e fundit bashkë, pasi të nesërmen do të ndaheshin nga shkolla që aq e deshën, nga shkolla me të cilën u lidhën ngushtë.

Maturantët ndahen dhe largohen fizikisht nga Medreseja, udhëheqja e saj, mësimdhënësit dhe edukatorët e tyre, mirëpo moralisht dhe shpirtërisht, sikurse çdo gjeneratë, me zemrat e tyre kurrë nuk do të ndahen nga Medreseja Alauddin!

Mbrëmjen e maturës së kësaj gjenerate e nderoi me pjesëmarrjen e tij edhe myftiu i BI-së të Kosovës, i cili iu drejtua maturatëve me një fjalë rasti, i uroi

dhe ua dha disa mesazhe të dobishme.

Fjalën përshëndetëse e mbajti edhe drejtori i shkollës, Fadil ef. Hasani, i cili i falënderoi të pranishmit, myftiun Tërnavë, për mbështetjen e pakursyer, ndërsa i uroi maturantët duke evokuar kujtime të gjeneratave të arta të medresesë, si dhe i falënderoi kujdestarët e të dy paraleleve, mësimdhënësit, edukatorët, administratën dhe stafin ndihmës.

Pastaj, fjala i kaloi Kujtim ef. Jashanicës, njërit prej dy kujdestarëve të këtyre dy paraleleve, i cili foli edhe në emër edhe të kujdestarit Adnan ef. Simnica, duke dhenë porosi të qarta për maturantët.

Përveç myftiut, në këtë mbrëmje prezantuan edhe: Islam ef. Hasani, dekan i FSI-së, Ekrem Simnica, drejtor për Diasporë, Almedin Ejupi, koordinator i Paraleles në Prizren, administrata e shkollës, mësimdhënësit, edukatorët dhe stafi ndihmës.

Programi i përgatitur prej maturantëve ishte i larmishëm dhe mjaftë i begatë.

Urojmë të gjithë maturantët, dhe u dëshirojmë suksese edhe në të ardhmen!





03.06.2023

## PROGRAMI I MBRËMJES SË MATURANTEVE TË GJENERATËS SË 22-TË

Mbrëmja e maturës, e mbajtur në Amfiteatrin e Madh të Medresesë, u hap me leximin e disa ajeteve nga Kurani i madhëruar, e pastaj me përshëndetjet dhe urimet më të mira për suksesin e tyre para mysafirëve doli kryetarja e KNSH-së e kësaj gjenerate, nx. Fjolla Miftari. Ajo i falënderoi të gjithë ata/o që kontribuuan për suksesin e tyre, duke filluar nga mbështetja e pakursyer e myftiut të nderuar, z. Naim ef. Tërnavë, Drejtorja e Medresesë, mësimdhënësit/et dhe edukatorët, e në veçanti kujdestarët/et e këtyre dy klasave, znj. Shaha Memishi dhe z. Rrahim ef. Aliu.

Me një fjalim rasti maturanteve iu drejtua edhe drejtori i shkollës, Mr. Fadil ef. Hasani, i cili fillimisht i uroi maturantët për suksesin e tyre, e më pas edhe i falënderoi të gjithë që kontribuuan në formësimin, arsimimin, edukimin dhe arritjen e rezultateve të tyre, ndërsa edhe shtoi se “nuk do të flasë gjatë, sepse ne, bashkë me stafin e Medresesë, kemi folur përmes punës dhe kushteve të shkëlqyeshme që ua kemi ofruar për tre vjet të shkollimit tuaj në Medresë”. Drejtori po ashtu shprehu lëvdatat më të mira për an-

gazhimin në mësim, sjelljen e mirë, aktivitetin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin e mirëfilltë për arritjen e rezultateve të kësaj gjenerate.

Në anën tjetër, edhe myftiu Tërnavë, në fjalën e tij, pasi i uroi maturantët, shprehu mirënjohje për punën e të gjithëve në Medresë, për realizimin e sukseseve të kësaj gjenerate dhe të shkollës në përgjithësi. Ai u premtoi maturanteve mbështetje edhe në të ardhmen, sidomos për zhvillimin arsimor të tyre.

Fjalë rasti në këtë mbrëmje mbajtën edhe dy kujdestarët e klasave, duke i uruar dhe duke i falënderuar të gjithë për këtë sukses.

Programi vazhdoi me pika të tjera kulturore e artistike të përgatitura prej maturanteve enkas për këtë mbrëmje, duke u prezantuar para profesoreshave dhe edukatoreve të tyre.

Mbrëmja u mbyll në ora 20:00.

Maturantët i urojmë duke lutur Zotin Fuqiplotë që të jetë i kënaqur me to, t'i ruajë nga çdo e ligë dhe t'u jap suksese!

Maturante, qofshi faqebardha dhe të suksesshme përherë, dhe të denja për përfaqësim të fesë islame!





## MEDRESISTET E MËSOJNË PËRMENDSH KURANIN FISNIK

Nxënëset e ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë, u zhvillua edhe një aktivitet tjetër jashtëkurrikular dhe mjaft fisnik, me titull “Të mësuarit përmendsh të Kuranit famëlartë”.

Këtë rezultat e arritën nën përkujdesjen e mësimeve të Kuranit, znj. Valbona Asllani dhe në mbështetje të pakursyer nga Drejtoria e Medresesë

Ato, për arritjet e tyre, u testuan në të nxënësit përmendsh nga juria e përbërë prej mësimeve të lëndës së Kuranit në Medrese: Bahri Simnica, Hatixhe Jashanica dhe Jakup Çunaku.

Nxënëset pjesëmarrëse në këtë test janë nga klasat e 10-ta, 11-ta dhe të 12-ta, e të cilat u testuan në katër nivele:

1. Në mësimin përmendsh të GJASHTË xhuzave,
2. në mësimin përmendsh të tre xhuzave,
3. në mësimin përmendsh të dy xhuzave, dhe
4. në mësimin përmendsh të NJË xhuzi.

Pjesëmarrëset:

GJASHTË XHUZA:

1. Suhejla Franca, kl. 12/3
2. Merjeme Shabani, kl. 11/4

TRE XHUZA:

3. Imrane Zariqi, kl. 12/4

DY XHUZA:

4. Jetmira Gashi, kl. 12/3
5. Medina Bregaj, kl. 12/3
6. Lule Lulaj, kl. 12/4

NJË XHUZ:

7. Medina Bajgora, kl. 11/5
8. Sara Gashi, kl. 11/5
9. Saima Hoti, kl. 11/5
10. Suhejla Çunaku, kl. 11/5.
11. Anisa Llapashtica, kl. 10/3, dhe
12. Melika Muhaxhiri, kl. 10/4.

Në fund të kësaj ceremonie për nxënëset u ndanë certifikata dhe shpërblime modeste.

Nxënëseve, hafëzeve të ardhshme, u urojmë sukses në rrugëtimin e tyre fisnik në nxënien e plotë përmendsh të KURANIT FAMËLARTË!





1. Suhejla Franca



2. Merjeme Shabani



3. Imrane Zariqi



4. Jetmira Gashi



5. Medina Bregaj



6. Lule Lulaj



7. Medina Bajgora



8. Sara Gashi



9. Saime Hoti



10. Suhejla Çunaku



11. Anisa Llapashtica



12. Melika Muhaxhiri







KLASA 10/1 | KUJDESTAR: **BESNIK JAHA**



KLASA 10/2 | KUJDESTAR: **MUHARREM TËRNAVA**



KLASA 10/3 | KUJDESTAR: **SHKELZEN HOXHA**



KLASA 10/4 | KUJDESTARE: **VALBONA ASLLANI**





KLASA 11/1 | KUJDESTAR: **EKREM MAQEDONCI**



KLASA 11/2 | KUJDESTAR: **DRITON ARIFI**



KLASA 11/3 | KUJDESTAR: **HYSNI BEKA**



KLASA 11/4 | KUJDESTARE: **HATIXHE JASHANICA**



KLASA 11/5 | KUJDESTAR: **SAMIR AHMETI**





KLASA 12/1 | KUJDESTAR: **ADNAN SIMNICA**



KLASA 12/2 | KUJDESTAR: **KUJTIM JASHANICA**



KLASA **12/3** | KUJDESTARE: **SHAHË MEMISHI**



KLASA **12/4** | KUJDESTAR: **RRAHIM ALIU**



# Thëniet e maturantëve

## KLASA 12/1

1. *Albert Teqolli: "If you think the price of winning is too high, wait until you get the bill from regret."*
2. *Amar Krasniqi: "Nga dituria është mos të flasësh pa dije."*
3. *Amar Simnica: "Nganjëherë mjafton një çast për të harruar një jetë, dhe nganjëherë nuk mjafton një jetë për të harruar një çast."*
4. *Arlind Sopa: "Jeta nuk ka të bëjë me gjetjen e vetvetes. Jeta ka të bëjë me krijimin e vetvetes." (George Bernard Shaw).*
5. *Bleron Sylja: "Imam Ebu Hanife, dijetar i shquar që me dijen e tij botën ka ndriçuar."*
6. *Burhan Avdullahu: "Me Allahun nuk ka fund të mërzitshëm!"*
7. *Edonit Ahmeti: "Fjala ka peshë të madhe, prandaj para se të flasësh, mendo, sepse fjala është zgjedhje e së ardhmes, e jo e së kaluarës!"*
8. *Eduard Baftiu: "Të qenët i fortë dhe i butë është një kombinim që shumë pak e kanë zotuar."*
9. *Emir Hyseni: "If you get tired of the journey remember the destination."*
10. *Emir Sogojeva: "E bukur është ajo zemër që jeton me shpresën se çdo gjë do bëhet mirë."*
11. *Engjëll Neziraj: "Shpresa është si dominotë. Kur njëra bie, të tjerat e ndjekin."*
12. *Enis Krasniqi: "Unë mund të luftoj vetëm për diçka që e dua. Unë mund ta dua vetëm atë që e respektoj, dhe mund ta respektoj vetëm atë që e kam njohuri mbi të."*
13. *Ensar Ramadani: "Great minds discuss ideas, average minds discuss events, small minds discuss people."*
14. *Eron Gashi: "Sprovat nuk janë test për fuqinë tënde, por janë test për lidhjen tënde me Allahun!"*
15. *Fisnik Aliu: "Lumturia e vërtet qëndron në devotshmërinë e zemrës."*
16. *Fuad Bajrami: "A little progress each day adds up to BIG results."*
17. *Haris Krasniqi: "Nothing lasts forever."*
18. *Ibrahim Halili: "Don't hope for a better life create it."*
19. *Leart Mehani: "Koha ecën shpejt, e tash ka filluar të vrapojë."*
20. *Miran Latifi: "Sabri e ka selametin."*
21. *Misin Halilaj: "We have one life it soon will be past what we do God is all that will last."*
22. *Muadh Rrustemi: "Humbja e kohës është më e shtrenjtë sesa vdekja, sepse humbja e kohës të largon prej Allahut dhe botës tjetër, e vdekja të largon nga kjo botë dhe njerëzit e saj."*
23. *Muhamed Bulliqi: "Kur merr atë që dëshiron, ai është udhëzim prej Zotit. Kur nuk merr atë që dëshiron, ajo është mbrojtje prej Zotit."*
24. *Muhamet Jetullahu: "Ata që duben për hir të Allahut, ndahen vet, ndahen vetëm një herë, për t'u bashkuar sërish nën hijen e Arshit."*
25. *Muhamed Llapashtica: "No man is free who is not master of his mind." (Epictetus).*
26. *Omar Sylja: "Je i lumtur kur prioriteti yt është kënaqësia e Allahut! Je i humbur kur mbi këtë prioritet e vendos kënaqësinë e krijesave!"*
27. *Omer Tahiri: "The only true wisdom is in knowing you know nothing, the more I know the more I realize I know nothing."*
28. *Shpat Krasniqi: "Fale namazin, o vëlla i dashur, sepse fjalët e fundit të jetës së Muhamedit, a.s., ishin: "Namazi! Namazi! Namazi!"*
29. *Shuajb Bytyqi: "Mesazhi më i mirë është ajeti i 88-të i sures Hud, ku thuhet: "...suksesi im varet vetëm prej Allahut. Tek Ai jam mbështetur, dhe Atij i drejtohem."*
30. *Valzon Makolli: "Success is not destination, it's a journey."*
31. *Yll Drit Obrashda: "Embrace Masculinity, Reject Modernity."*



# Thëniet e maturantëve

## KLASA 12/2

1. Adnan Smajli: "Shoqëruesi më i mirë drejt suksesit është brenga për të".
2. Albion Kamberi: "Duro, se durimi është çelësi i ditëve të lumtura, duke e përdorur atë në ditë të vështira!".
3. Almir Isaku: "Mëso dallimin mes besimtarit dhe myslimanit, sprovës dhe dënimit, qejfit dhe dëshirës për Xhenet!".
4. Almir Musliu: "Jeta është një udhëtim, jo një destinacion".
5. Amër Suma: "Nëse dëshiron të shkëlqesh si dielli, së pari duhet të digjesh si ai".
6. Arb Mustafa: "Man's way leads to a hopeless end, while God's way leads to endless hope".
7. Arian Asllani: "Po të ishte i rëndësishëm trupi, Zoti nuk do ta merrte shpirtin".
8. Artiol Behluli: "Një mysliman i mençur nuk shikon ngjarjet, por më tepër ata që qëndrojnë pas atyre ngjarjeve".
9. Edis Kutllovci: "Nëse dëshiron të vraposh, së pari mëso si të ecësh!".
10. Elvir Bytyqi: "Vetëm tri gjëra kanë vlerë në këtë botë, e ato janë mendimi, fjala, ndjenja".
11. Enes Jashari: "Zgjedhe vetminë mbi shoqërinë e keqe!".
12. Enes Rashica: "Çdo arritje fillon me dëshirën për ta provuar atë".
13. Enis Mehmeti: "Humbja është fitore, nëse merr mësim prej saj".
14. Enmar Islami: "I need a room full of mirrors so I can be surrounded by winners"
15. Ensar Abazi: "Njeriu e nënvlerëson atë çka mund ta bëjë brenda një dite, dhe e mbivlerëson atë çka mund ta bëjë brenda një viti".
16. Erblin Grajqevci: "Mos i nënvlerëso mirësitë e Allahut, sepse rrallëherë kthehet një mirësi tek ti nëse ajo veçse është larguar më parë!".
17. Florent Aliu: "Mos e ngrit gjoksin tepër lart, se mund të të deformohet kurrizi, e pastaj gjatë tërë jetës mund të vuash nga dhimbjet!".
18. Fuad Shatri: "Real ones don't chase, we replace." (Donald J. Trump).
19. Haris Hoxha: "Dëgjo me zemër, ngase veshi gënjen, ndërsa shiko me mendje, ngase syri gënjen!".
20. Husejn Idrizi: "Kjo shkollë e bekume shkoi, po a u bekuam ne?!"
21. Ibrahim Gjokolli: "Përkushtimi ndaj prioriteteve shpërblehet me avancim".
22. Ilirik Aliu - "Fol bukur, ose zbukurohu me heshtje!".
23. Mexhid Tërnavat: "Gjej për çfarë do të vdisje, pastaj jeto për të!".
24. Mubamed Asllani: "Allahu nuk e lë pa halle robin e tij, pasi që dashuria kërkon një çmim".
25. Mubamed Kuleta: "إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ".
26. Mubamed Morina: "Tre vjet kaluan, dhe lodhja shkoi, e mbeti dija dhe punimi me të".
27. Omer Ferizi: "Kush të fitoi, që të të fitoja unë".
28. Sokol Malsiu: "Në këtë jetë kurrë krejt s'ke për t'i ditur, vetëm se është mirë ta dish se jeta s'është vetëm një ditë!".
29. Uthman Pantina: "Nuk është i vlefshëm besimi që nuk na sjell në veprim, dhe as veprimi që nuk na sjell në besim. Besimi dhe veprimi janë dy anët e një medaljeje të quajtur fe, e cila na ndihmon në udhëtimin tonë drejt lumturisë dhe begatisë në botë dhe në ahiret".





# Thëniet e maturanteve

## KLASA 12/3

1. Adelina Ruhani: "Një ditë do të takohesh me veprat tua, prandaj bëj vepra që të gëzon takimi me to!" (Bekir Halimi)
2. Amina Rahova: "No matter how you feel, get up, dress up and show up!"
3. Anisa Bytyqi: "Dinjiteti është shpirti juaj i dytë, prandaj ruajeni atë, që mos të vdisni dy herë!"
4. Anisa Dibrani: "Shembulli i besimtarit është si shembulli i bletës, e cila nuk ushqehet vetëm se me të mirën, dhe nuk jep vetëm se të mirën." (Muhamedi, alejhi selam)
5. Drenushë Gashi: "Ushroje mendjen tënde, që ta shohësh të mirën në çdo situatë!"
6. Elda Kadriu: "I'm a barbie girl..."
7. Elmedina Llapashtica: "And they ask you where to find beauty, tell them in the faces that are ashamed of Allah."
8. Emira Latifi: "Oh sa më ka marrë malli për Atë që më sheh dhe nuk e shoh!"
9. Esmë Rrustemi: "Should've burned this place down when I had the chance." (Michael Scott)
10. Fatina Bardhi: "Nuk e urren vdekjen përveçse i dyshimti, sepse vdekja e afron të dashurin tek i Dashuri (Allahu)." (Jahja bin Muadh)
11. Fjolla Miftari: "I trust the next chapter because I know the author..."
12. Jetmira Gashi: "E do urtësinë? Lëri fjalët e tepërta!" (Abdullah bin Mubareku)
13. Krenare Lipovica: "Karriera e besimtarit është Xheneti. E ju Zoti shpirtin jau marrtë me shehadet! Amin!"
14. Lea Curri: "Cheaters never win but I graduated."
15. Leoneta Duriqi: "Medrese, dikur ishe një ëndërr femijërore, kurse tani je kujtimi më i bukur i jetëve tona."
16. Leonora Pacolli: "Kur të njeh Krijuesi kush je, mos u mërzit çka thonë njerëzit për ty!"
17. Medina Bregaj: "Puno me veten në heshtje, derisa ta arrish versionin më të mirë!"
18. Medina Miftari: "Të kam falur, që mos të takohemi më para Allahut!"
19. Medina Uka: "Fol mirë, ose mos fol hiç!"
20. Natyra Alishani: "Vetëm nëse je perfekt mund të gjykos." (Robert Kiyosaki)
21. Rinesa Rabushaj: "Not all goodbyes are sad. Example: goodbye school."
22. Rumejsa Hyseni: "Don't let the fear of losing be greater than the excitement of winning." (Robert Kiyosaki)
23. Rumejsa Muhaxheri: "I make shoe contact before eye contact."
24. Rumejsa Raçi: "Tokë është e rrumbullakët (rrrotullohet), mirëpo kush ikën, nuk kthehet më."
25. Rumejsa Rrustemi: "I don't like people, I just like all types of Motorcycles."
26. Ruvejda Zhushi: "Alexa, turn on the graduation."
27. Samire Gashi: "Honesty is a very expensive gift. Don't expect it from cheap people."
28. Samuela Karpuzi: "If you want to change the world, start with yourself."
29. Sara Ceka: "Askush nuk e kupton zemrën tënde më mirë se Ai që e krijoi."
30. Sara Neziri: "Ctrl c... my way outta here."
31. Subejla Franca: "Vizualizojë verzionin më të lartë të vetes sate, pastaj ji ajo!"
32. Sumeja Gashi: "Shoqëria për hir të Allahut është një lule e rrallë, e që shumë persona, duke mos ditur ta mbajnë, e lënë të vshket."
33. Venera Hoti: "Her şeyi zamana biraktık. Zamanımız var mı bilmeden." (Özdemir Asaf)
34. Yllka Sfishta: "E mira bëhet në heshtje, çdo gjë tjetër është teatër."
35. Zejneb Vrapca: "Nuk ka gjë më të dëmshme për njeriun sesa tubimi i dijes dhe lënia e veprës."

ein  
ganz  
vollständig,  
A nich im Felde  
is zu einem Gewinn



# Thëniet e maturanteve

## KLASA 12/4

1. Albina Bekolli: "Gjithçka kalon, po edhe gjithçka nuk harrohet."
2. Albina Musliu: "Judge me when your perfect."
3. Albiona Musliu: "Your time is limited, so don't waste it living someone else's life."
4. Alketa Kadriu: "Dëshiroja që të ndodhte, dhe ndodhi."
5. Alma Berisha: "Gjithmonë duket e pamundur, deri sa të arrihet."
6. Anesa Marevci: "Hiçbir şeyimiz olmadan geldik ve her şeyimiz ile ayrılıyorruz."
7. Anisa Haliti: "If the earth is flat then explain how my life has been going downhill consistently."
8. Anisa Mehmeti: "Everything negative are all opportunities for me to rise."
9. Arnesa Hasani: "Të këndshme janë ato rastësi që më pas bëhen përjetësi."
10. Blearta Beqiri: "Pas çdo vështirësie vjen lehtësimi... Elhamdulillah!"
11. Dafina Surkishi: "The right eyes will know your worth..."
12. Eljesa Bunjaki: "Pas ca ditësh secila prej nesh shpërndahet nëpër tokë, përveç duave për njëra-tjetrën që shpërndahen nëpër qiiej."
13. Emira Hajdini: "E si ta harroj zemra atë që ia qetëson shpirtin?!"
14. Erina Salihu: "No one would've accepted to meet and hear you 5 times a day, in any emotional state or any circumstances and heal you except your Lord."
15. Ermira Ramabaja: "There's so much I wanna say, but nah..."
16. Esra Nika: "I went through three years of high school without having bad hair day - Hijabi girls."
17. Ferdevesa Krasniqi: "Dyngajaja, sprovë"
18. Fjolla Uka: "New chapter."
19. Gjyla Rexhepi: "Güzeli güzel yapan edeptir, edep ise güzel sevmeye sebeptir."
20. Hana Kastrati: "Everything is not what it seems."
21. Inrane Zariqi: "Ja Rab, nëse nuk kemi jetë për një bashkim të dytë, le të bëhet Xheneti destinacion i dytë për ne!"
22. Kanita Rama: "E di që krejt këto i keni dëgjuar, por përkujtimi bën dobi."
23. Lule Lulaj: "Të bukur në fytyrë ka plot, por të bukur në shpirt janë pak."
24. Medina Halilaj: "Nuk i bën dobi një zemre përveçse ajo që del prej zemrës tjetër."
25. Meka Bilalli: "So, just do the best you can and choose whichever you'll regret the least." (Levi Ackerman)
26. Melika Rama: "Not everything is meant to last forever."
27. Merisa Osmani: "Ëndërr në ëndërr."
28. Merjeme Kadriu: "Believe you can and you're halfway there."
29. Romesa Krasniqi: "It was painfully beautiful, but we're in the end now. And perhaps, we'll only meet on the roads of my soul."
30. Sara Gashi: "Dil Çok Keskin Bir Kılıçtır Kan Akitmadan Can Yakar."
31. Sara Halili: "Some things have to end for better things to begin."
32. Sarafina Retkoceri: "When the world pushes you to your knees, you're in the perfect position to pray." (Ali bin Ebi Talibi)
33. Subejla Dervishaj: "If your tired, learn to rest not quit".
34. Unejsa Krasniqi: "Unë maturantja e fundit e kësaj gjenerate të artë, po e përmbyll këtë kapitull duke thënë: Shihemi pas 10 vitesh, INSHAALLAH!"



## VENDI KU LINDA

*Vendi ku linda  
Vendi ku jetoj  
Kujtimet që mbesin  
Kurrë s'do t'i harroj*

*Vitet që kalojnë  
Këtu do t'i jetoj  
Me vendlindjen time  
Asgjë s'e krabasoj*

*Shoh burra e gra  
Të lumtur në këtë tokë  
Malli që kam për atdhe  
Sytë m'i mbushën lot*

*Aty pashë dritën  
Që askund s'e ndjeva  
Të jetoj larg saj  
Nuk ma duronte zemra!*

*Enes Tabiri 11/2*

## LARG FAMILJES

*Larg familjes në gurbet  
Dheu i huaq po na tret  
Sa shumë po na mbyl ky mall  
Familjen po i shohim rrallë*

*Disa vite pa i takuar  
Shumë dua me ju përqaftuar  
Ah sa shumë më mungoni  
M'ka marr malli, më besoni*

*Erda Musliu 10/4*



## ULQINI

*Nuk është vendi ku unë kam lind,  
Po me të vërtet ajo m'ka bind,  
Se aromë më të mirë s'ma ka taku dera,  
Si e Ulqinit kur vjen vera.*

*Ne thamë se ai vend ka mangësi,  
Syve të mi ua kisha vu fajin,  
Se ato toka janë mbushur plot begati,  
S'i kisha krahasu as me arin.*

*Duke ia fillu nga qielli i gjanë  
Kuqërremët kur dielli qan,  
Sikur lulet ndër kodrat e gjelbra,  
Duken bukur edhe netët e errëta.*

*E kur Hana na ka mbulu,  
Duken bukur dhe shtëpizat me gurë,  
Edhe yjet plot shndërrime,  
Janë njerëzit aty që rrinë.*

*Po te ngrihesha te kalaja,  
Veshët e mi i prek vala,  
Vala e detit qe xixëllon,  
Që kur bie ne gjumë e ëndërron.*

*Po ti tregoja pyjeve se çfarë ndiej,  
Çka kish pas zogj ish' nis këndej,  
Malli shpirtin ma ka mbërthi,  
Edhe një herë me e sodis me sy.*

*Po ta dija frymën e fundit ku e kam,  
Aty me qejf do ta kisha dhanë,  
Aty edhe shpirti n'ajri më pushon  
E zemra shpesh atë vend ma kujton*

*Dashuria është më e madhe se fjalët e mia,  
Prandaj po vendos të ri në qetësi.  
Dhe pse vitet i janë shtuar Ulqinit,  
Ai qëndron i ri ne vargjet e nxjerra me dashuri*

Dua Çmega 11\4





## NGA ERRËSIRA NË DRITË

O ti që je i humbur!  
Kërko dijen pse rri ulur?  
Shiko botën rreth e qark!  
Thirri mendjes vetëm pak!

Mos rri kot, se s'ka dobi!  
Lexo, mëso, merr dituri!  
Ndize dritën që e ke fik'!  
Je n'errësirë, e nuk ke frik.

O ti që ke një pikë sedër!  
A nuk sheh, a je i verbër?  
Pse s'mëson, çfarë t'mungon?  
Çfarë la Zoti, pse s'kërkon?

Bota është veç iluzion.  
Pse atëherë ty po t'mashtron?  
Po, pra, pse nuk e kupton?  
A thua vallë ti s'po ndëgjon?

Ec shumë lart, mos rri n'errësirë!  
Nuk është vonë për çdo të mirë.  
Kërko dijen hiç pa ndal'!  
Mos ndalo për asnjë fjalë!

Dil, pra, ti nga ku je futur!  
Hapi sytë, po ku je struktur!  
Hape zemrën për të mirë!  
Ke per t'pasur dritë n'errësirë.

Eljesa Bunjaki 12\4

## VATËR E DITURISË

Ai vend ku nderin edhe më shumë mësova  
Ai vend ku shoqërinë e kuptova  
Ai vend që me Allahun më afroi  
Ai vend që zemrën ma qetësoi  
Ai vend është Medreseja, vatër diturie  
Kësaj Prishtinës sot sa fort i ka hije

Shpresa Zeka 11/5





## KURANI

*Mora lapsin në dorë  
Të shkruaj diçka  
Jashtë po binte borë  
E mbushte bardh*

*I pashë ato shkronja  
Që më thirrën mua  
Më thanë t'i lexoja  
Që të jem i gëzuar*

*U preka në zemër  
Ato fjalë duke i shqiptuar  
Dhashë një urdhër të prerë  
Atë për ta mësuar*

*Aq më që shumë lexoja  
Aq më mirë ndihesha  
Kur siç thoshte veproja  
Sa i gëzuar që isha*

*Lash lapsin mbi tavolinë  
Fillova të mendoj  
E luta Zotin tim  
Në xhenet të na bashkojë*

*Shpëtim Smajli 10/1*



## BASHKIMI I SHQIPËRISË

*Nuri i Prishtinës  
Vatër e diturisë  
Është medreseja  
Bashkimi i shqiptarisë*

*Duke filluar me Mitrovicë  
Prishtinë e Kamenicë  
Vushtrri e Ferizaj  
Shkupi bashkë me Kavajë*

*Medreseja të gjithëve na bashkon  
Askush prej nesh nuk dallon  
Fenë islame ne e mësojmë  
Të gjithë bashkë Xhenetin e synojmë*

*Kanita Hyseni 11\5*



## PRAYING AND SALAH

whenever something goes wrong  
You know where you belong  
Even if things are going good  
You put your head in sujood  
Tears in eyes  
Head in sujood  
No one can match  
The power of Tahjud  
when words don't come out  
The heart speaks to it's creator  
The one and only saviyour


*Arjeta Grajçevci & Xheneta Gashi 11/5*

## A FORGOTTEN FRIEND

A light, easy to carry object, yet so heavy with different worlds and ideas. Those small, flat, rigid pieces of paper unfold world after world, moment after moment and make you feel like you belong there. One glance at a page and your imagination starts expanding. There's a whole new world, new people waiting for you to flip the pages and discover more of its secrets. To sit and read is to voyage through time, to experience the beauty of travelling without having to move at all. A book gives you unknown friends, people who you feel close to even though you've never really met them. Reading is a way of escaping your own reality and helplessly slipping into another's mind and voice, and feeling a connection with them. A book is what gives you warmth and coziness on those cold late nights. A book is a quiet wise friend who has a lot to reveal, who's always waiting for you to reach out and be amazed at what it has to offer.

"If you don't like to read, you haven't found the right book" J. K. Rowling

*Rumejsa Hyseni 12\3*





## ذكريات جميلة لا تنسى

أولاً، أشكُرُ الله تعالى على أنه مكَّنني أن أكون جزءاً من هذا الفضل. الحمد لله أننا أتينا إلى هذه المدرسة و تعرّفنا على بعضنا البعض. أعتقد أننا قضينا أجمل ذكريات حياتنا هنا في المدرسة، لأننا الآن أكثر نُضجاً مما كنا عليه من قبل، و نفهم الأشياء الآن أفضل بكثيرٍ من ذي قبل. بدأنا العام الدراسي الأول بصعوبةٍ لأنه كان وقت الوباء، لكننا أمهيناهُ بأفضلٍ و أحسن نجاح. سنبتدئ العديد من اللحظات التي عشناها معاً. سوف نتذكر الأستاذ الذي كنا نمزح معه و أعددنا له كاميرات خفية. و العديد من الذكريات الأخرى. هكذا نقرب من الموت أكثر فأكثر. كانت المدرسة المكان الذي يُذكر فيه اسم الله تعالى. و كان المكان الذي سيبقى فيه أفضل الذكريات بعد مغادرتنا. لن نطلق علينا بعد الآن خريجات المدرسة. لن نأكل الفطور هنا مرةً أخرى، لكن لا تنس أننا تعلمنا في هذه الطاولات المدرسية. نشأنا مع بعضنا البعض. وبقينا معاً في الأوقات الصعبة. أخواتي الكريمات: أتمنى لكن كل التوفيق في الدنيا و الآخرة، و لا تنسينني في دعائكن. ييها أنت يا أستاذ، نطلب منك السماح و الحلال. و نسأل الله تعالى أن يرحمنا جميعاً و يدخلنا في رحمته، و أن يجمعنا في جناته بلطفه و كرمه، اللهم آمين.

Pergatiti: Zejneb Amatullah Vrapca 12/3





MË DATË 15.03.2023, NË SALLËN E SPORTIT, NË AMBIENTET E SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN"

## U MBAJT TURNIRI I VOLEJBOLLIT PËR VAJZA

Pjesëmarrës ishin paralelet e Prishtinës, të Prizrenit dhe të Gjilanit, të cilat garuan me ekipet e tyre më të përgatitura. Pas lojërave të mira dhe mjaft konkurruese ndërmjet ekipeve, fitues dolën:

1. Prishtina - vendi i parë
2. Gjilani - vendi i dytë
3. Prizreni - vendi i tretë

Ngjarjet e këtilla, në ambientet e shkollës sonë e shtojnë gjallërinë e jetës shkollore, dhe sigurisht se kontribuojnë edhe në zhvillimin e aktivitetit fizik, krahas diturive të mirëfillta në këtë vatër të dijes. Pra, Medreseja mbetet edhe fole e aktiviteteve të vazhdueshme e të pandalshme sportive.



## TURNEU I BASKETBOLLIT PËR MESHKUJ

Për hir të Ditës së Shkollës, 1 Nëntorit, në shkollën amë u zhvilluan gara në basketboll ndërmjet 6 ekipeve të paraleleve të djemëve.

Kurse, më datë 03.11.2022 është zhvilluar finalja e turnirit të basketbollit, në paralelën e djemve të ShML "Medreseja Alauddin" -Prishtinë ndërmjet klasës së 12/1 dhe asaj të 11/1, e me këtë rast fituese doli klasa 11/1.

*Almir Isaku 12/2*





## OLIMPIADA MATEMATIKE E KOSOVËS (OMK) NË NIVEL KOMUNAL

Më datë 19.11.2022 në ShMU "Dardania" në Prishtinë është mbajtur Olimpiada Matematike e Kosovës (OMK) në nivel komunal, në të cilën pjesëmarrës ishin edhe nxënësit e ShML "Medreseja Alaud-din" - Prishtinë, nën përkujdesin e mësimdhënësit të matematikës, profesorit Leonard Morina.

Shkollën tonë e përfaqësuan:

1. *Shpëtim Smajli, 10/1,*
2. *Esmë Metolli, 10/4,*
3. *Art Salihu, 11/1,*
4. *Someja Berisha, 11/4,*
5. *Almir Isaku, 12/2,*
6. *Anisa Haliti, 12/4 dhe*
7. *Erina Salihu, 12/4.*

Almir Isaku 12/2



## SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË FITUESE E GARËS NË ESE

Më 27.01.2023 u mbajt gara në ese, kurse më 03.02.2023 u shpallën rezultatet finale.

- Ron Bajoku kl. 10/2 e fitoi Vendin e Parë në garën letrare në ese, me esenë me titull "Ku po shkojmë me kaq shumë ligësi?!".

- Në mesin e 10 shkollave të mesme të Prishtinës, me rreth 70 nxënës pjesëmarrës, ShML "Medreseja Alaud-din" doli e para në garën e esesë të organizuar nga Qendra Social-Edukative "Don Bosko" - Prishtinë.

- Medreseja në këtë garë u përfaqësua nga dhjetë nxënës, e në dhjetshën e parë, nga të gjithë garuesit e shkollave të mesme të Prishtinës, përveç Ron Bajokut, ishin edhe: Imrane Zariqi, Rumejsa Raçi dhe Sumeja Tahiri.

- Pjesëmarrësit nga ShML "Medreseja Alaud-din" Prishtinë ishin:

1. *Ron Bajoku, 10/2, vendi i 1-rë - fitues i garës*
2. *Imrane Zariqi, 12/4, vendi i 4-të*
3. *Rumejsa Raçi, 12/3, vendi i 6-të*
4. *Sumeja Tahiri, 10/3, vendi i 7-të*
5. *Ilirik Aliu, 12/2,*
6. *Enis Krasniqi, 12/1,*
7. *Lumnije Sadiku, 10/4,*
8. *Diellëza Berisha, 10/4*
9. *Sumeja Gashi, 12/3, dhe*
10. *Krenare Lipovica, 12/3.*

Medreseja është krenare me nxënësit e saj, kurse nxënësit u shprehën se "Medreseja është krenaria jonë, dhe ne jemi krenaria e saj."





## MREKULLITË SHKENCORE NË KURAN

Ky libër i qartë, si e vërtetë absolute e Allahu Fuqiptotë, ka ajete shkoqitëse për ata që mendojnë për krijimin e shtatë qiejve dhe të Tokës, si dhe të vetë të zotëve të mendjes. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran: "...do t'jua bëj të qarta argumentet, e ju mos u nxitoni!". Pra, Allahu na e bën me dije se ne do t'i shohim mrekullitë e Tij, të cilat i ka bërë argument për çdo jobesimtar, po edhe për të gjithë ne. Allahu, xh.sh., në Kuran nuk kursen as nga shenjat e jashtëzakonshme, e që pa dyshim se e vërtetojnë edhe më tej vërtetësinë dhe pagabueshmërinë e këtij libri hyjnor. Allahu, xh.sh., na kumton ajete në shumë fusha shkencore, si kurse në: astronomi, biologji, gjellogji, mjekësi, histori e popujve të lashtë etj.

Allahu, xh.sh., thotë në Kuran, në suren El Enbija: "A nuk e shohin ata që mohuan se qiejt dhe Toka ishin të ngjitura, e ne i ndamë ato, dhe nga uji e bëmë çdo gjë të gjallë?! A nuk besojnë?!".

Rreth 14 shekuj pas zbritjes së këtij ajeti, shkencëtarët zbuluan se universi në krijimin e tij ishte një pikë materie, gati pafundësisht e dendur, dhe pastaj shpërtheu, dhe se universi vazhdon të shpërndalet edhe sot. E, si mund ta ketë ditur Muhamedi, a.s., para 1400 vjetësh, në mes të shkretëtirës, duke qenë se nuk dinte as shkrim dhe as lexim?!

Po ashtu në suren Edh Dherijat Allahu, xh.sh., thotë: "Dhe qiejt i krijuam ne nga fuqia Jonë, dhe ne e zgjerojmë atë.". Po, në këtë shekull që jemi tash shkencëtarët zbuluan se galaktikat largohen gjithmonë e më shumë nga njëra-tjetra, duke bërë kështu që universi të zgjerohet vashdimisht.

Këto janë pak nga disa ajete bindëse për çdo mendje të shëndoshë e arsye të mirë. Mirëpo, shtrohet pyetja se, përse njeriu, edhe pas gjithë këtyre argumenteve, prapë nuk beson?!

Kjo sepse udhëzimi është vetëm në Dorë të Allahut të Lartmadhërishëm, dhe zemrat e shumë njerëzve janë të verbra, prandaj edhe shumë prej njerëzve janë të pavëmendshëm ndaj shenjave të Allahut.

*Shuajb Bytyqi 12/1*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
**SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË**



12/1



12/2



الَّذِي كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا قَوْمًا فِي الشُّعْبِ  
 كَسَجْنٍ وَأَخْبَرُوا أَنَّ لَهُمْ جَنَّةً فِي السَّمَاءِ  
 "Vallë, a nuk e ke parë se si Allahu e ka sjellë shembul-  
 lin e një fjale të mirë, si një pemë e mirë që rritet i ka  
 të forta (të tokës), kurse degët nga qielli?"  
 (Ibrahim, 24)

Gjenerata 56  
 TAKIMI  
 2020/2023





Republika e Kosovës  
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës  
**Sh.M.B. "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË**

**NXËNËSIT  
E DALBUAR**



**AMER SUMA** 12/2  
më i dalluari në nivel shkollë

**VITI SHKOLLOR  
2022/2023**



**SHUAJB BYTYQI** 12/1



**ALBION KAMBERI** 12/2



**ART SALIHU** 11/1



**ENES GANIU** 11/2



**SHUAJB RAMADANI** 11/3



**SHPETIM SMAJLI** 10/1



**RON BAJOKU** 10/2



Republika e Kosovës  
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës  
**Sh.M.B. "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË**

**NXËNËSET  
E DALBUARA**



**FJOLLA MIFTARI** 12/3  
nxënëseja më e dalluar në nivel shkollë

**VITI SHKOLLOR  
2022/2023**



**ZEJNEP AMATULLAH VRAPCA** 12/3



**ERINA SALIHU** 12/4



**DUA OMEGA** 11/4



**MEDINA BAJGORA** 11/5



**HAXHERE IDRIZI** 10/3



**RUVEJDA BEJTULLAHU** 10/4